REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

# PROJEKT VENDIM

Nr.____,datë__.__.___.2024

## PËR
## VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE TË BASHKISË PËRMET PËR VITET 2025-2027

Në mbështetje të neneve 8,9,34-37,54,shkronja "f", 55 pika 3 të Ligjit nr.139/2015,datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore",kreu III,nenit 34 pika 1-3 të ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore",Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë",i ndryshuar,Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar,Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 "Për proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë",i ndryshuar,Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financjar dhe kontrollin",i ndryshuar,Udhëzimin nr.7 datë 28.02.2018 të Ministrisë së Financave "Për proçedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm",Këshilli i Bashkisë,me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

## VENDOSI:

1.Të miratojë vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Përmet për vitet 2025-2027 sipas dokumentit bashkëlidhur.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë Përmet,Njësive Administrative dhe Institucioneve të Varësisë.

3.Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I BASHKISË**

**Alma HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA PËRMET

Sheshi "Abdyl Frashëri", tel.+35581322254,e-mail:info@bashkiapermet.gov.al

**Vlerësimi dhe parashikimi afat mesëm I të ardhurave të veta të Bashkisë Përmet 2025-2027**

Të ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës nga burimet qendrore. Këto burime të ardhura bashkia I përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara ngaLigji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Planifikimi i te ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Përmet, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajon çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj.

Paketa fiskale e Bashkisë Përmet për këtë kategori e hartuar dhe e ndryshuar edhe me përfshirjen e përfaqësuesve të komunitetit të biznesit e më konkretisht biznesit të madh dhe të vogël, banorë vetë njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit, këshilltarë etj., pasqyron disa politika të rëndësishme për uljen e disa niveleve ligjore /kufi, etj. Sipas kompetencave ligjore, si më poshtë:

Politikat incentivuese në taksa:

- Taksë 0 (zero) ndërtese për qëllime banimi për invalidët kryefamiljare.
- Taksë 0 (zero)për familjet e pensionisteve te vetmuar.

Politikat incendivuese dhe uljet nën nivelet e kostos se sherbimit të llogaritur:

- Tarifa e pastrimit 0 (zero) për familjet me ndihmë ekonomike.
- Tarifa e pastrimit 0 (zero) për familjet e pensionisteve të vetmuar.
- Tarifa të reduktuara 50% sipas kritereve për pensionistë, invalidë, etj.
- Tarifa 0 (zero) për familjet me kryefamiljarë invalidë, veteranë e të verbër.
- Subjektet të cilët do të punësojnë mbi 30 persona përjashtohen një vit nga tarifat vendore.

Procesi I planifikimit të të ardhurave të veta u realizua në bashkëpunim me administratën e bashkisë, me Njësitë Administrative, me Institucionet e Agjentët tatimorë, etj. Vazhdimi I këtij procesi bashkëpunues do të mundësojë sigurimin e të ardhurave, me efekt përmirësimin e

mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorin e bashkisë.

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat, të ardhurat nga tarifat dhe të ardhurat nga burimet e tjera.

Zërat e taksave dhe tarifave që ndikojnë pjesën më te madhe të planit të të ardhurave nga burimet e veta janë kryesisht tarifat për pastrimin që zë rreth 18% të tij, taksa e pasurisë së paluajtshme që zë rreth 17%, taksa e ndikimit në ifrastrukturë që zë rreth 15%, taksa e mjeteve të përdorura që zë rreth 5%, tarifa e ndriçimit publik që zë rreth 6%, tarifa e gjelbërimit që zë rreth 3 %, tarifa për kullot je bagëti e që zë rreth 2 %. Këto zëra kryesorë mbulojnë rreth 66 % të planit të të ardhurave të Bashkisë Përmet.

Administrata e Bashkisë ka pasur parasysh që në ndryshimet e paraqitura për zërat e të ardhurave që lidhen me pasurinë e paluajtshme ( takes trualli, takes ndërtese dhe taksa e tokës bujqësore )do të ndikojë zgjerimi I bazës së taksa paguesve nëpërmjet:

- Saktësimit dhe vlerësimit të drejtës I përfaqësuese nëpërmjet grupeve të punës të ngritura për këtë qëllim,
- Mbështetja nga agjentë tatimorë.
- Ndarjes në këstet e pagesave, ( për taksën e ndërtesës për popullatën )
- shtrirje e mëtejshme e bazës taksa paguese, falë politikave fiskale lehtësuese dhe incentivave të ndërmarra, rivlerësimit të gjendjes faktike, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksa paguesin, si dhe bashkëpunimit të pritshëm me institucionin ASHK.

Ndryshimi në zërin e Taksës së ndikimit në infrastrukture parasjet potencialin për dhënien e lejeve të ndërtimit pas hartimit të PPV dhe kërkesave të paraqitura deri më tani.

Për sa I takon tarifave vendore nuk janë paraqitur ndryshime esenciale në parashikimet për vitet 2025-2027

pasi nga të dhënat statistikore që Zyra e Tatim Taksave ka në arritjet e kapaciteteve paguese ( shtim të familjeve apo të bizneseve ). Një rritje e lehtë e tarifës së ndriçimit dhe pastrimit pasqyron shtimin në kapacitetet paguese dhe një përafrim të kostos me shpenzimet e kryera.(Me të ardhurat e realizuara nga tarifa e pastrimit mbulohet 70% e kostos)

Tabela e më poshtme pasqyron planin e të ardhurave të veta, të kategorizuar si pas klasifikimit ekonomik ligjor:

Ju faleminderit!

Pergjegjesi Tatim – Taksa

**Dorjan METKO**

# Te ardhurat afatmesme Bashkia Permet vitet 2025-2027

000 lek

| NR | LLOJI I TE ARDHURAVE | Realizim i 2022 | Realizim 2023 | Plan Viti 2024 | Planifikim Viti 2025 | Planifikim Viti 2026 | Planifikim Viti 2027 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | TE ARDHURA TATIMORE | 24649 | 26671 | 24483 | 31672 | 31767 | 32020 |
| 1 | Taksa mbi ndertesat | 5565 | 9251 | 9881 | 9892 | 9900 | 9920 |
| 2 | Taksë mbi truallin | 961 | 1117 | 940 | 870 | 880 | 890 |
| 3 | Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin | 113 | 286 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4 | Takse e ndikimit infrastr. nga ndertimet e reja dhe legalizimet | 5818 | 3793 | 3700 | 10760 | 10770 | 10780 |
| 5 | Takse mbi kalimin e te drejtes se prones. | 179 | 201 | 250 | 1460 | 1470 | 1480 |
| 6 | Takse Rregjistrim automjeti | 5290 | 5648 | 4617 | 3980 | 3992 | 4000 |
| 7 | Taksa Tabele | 340 | 380 | 300 | 310 | 320 | 330 |
| 8 | Takse mbi token bujqesore | 1537 | 1964 | 1825 | 1840 | 1855 | 1865 |
| 9 | Takse fjetje ne hotel | 56 | 103 | 110 | 120 | 130 | 140 |
| 10 | Tatim mbi te ardhurat personale | 5555 | 4577 | 3341 | 2440 | 2450 | 2460 |
| B | TE ARDHURA JOTATIMORE | 25486 | 35906 | 33670 | 39650 | 39852 | 19990 |
| 1 | Tarifa Pastrimi | 11272 | 14803 | 19220 | 13280 | 13300 | 13330 |
| 2 | Tarife Ndricimi | 3360 | 4359 | 4550 | 4560 | 4585 | 4020 |
| 3 | Tarife Gjelberim. | 1596 | 2080 | 1970 | 1980 | 1995 | 2000 |
| 4 | Leje Rregjistrim Veprimtarie | 1073 | 255 | 1800 | 1500 | 1500 | 1530 |
| 5 | Qera Objekt | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 6 | Te ardhura nga Cerdhja | 306 | 2952 | 1500 | 4870 | 4895 | 4915 |
| 7 | Tarife Parkimi | 61 | 53 | 250 | 365 | 370 | 380 |
| 8 | Tarife per lende drusore | 909 | 612 | 690 | 825 | 830 | 835 |
| 9 | Tarife zenie hapesire publike | 468 | 558 | 630 | 870 | 882 | 890 |
| 10 | Tarifa kullotje bagetie | 1386 | 1278 | 1350 | 1570 | 1610 | 1520 |
| 11 | Tarife mirembajtje kanale vaditese | 315 | 132 | 370 | 975 | 380 | 385 |
| 12 | Te ardhura nga qera per troje | 967 | 6027 | 5370 | 5670 | 5695 | 5700 |
| 13 | Tarifa sherbime nga urbanistika | 2019 | 2071 | 1000 | 2130 | 2140 | 2150 |
| 14 | Tarifa sherbimesh te [illegible] | 81 | 107 | 250 | 135 | 140 | 145 |
| 15 | Te tjera te ardhura | 3082 | 3254 | 500 | 1520 | 1530 | 1540 |
| | TE ardhura vjetore | 50135 | 62577 | 58153 | 71322 | 71619 | 72010 |

Pergjegjesi i Tatim-Taksave

Dorjan METKO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

**PROJEKT VENDIM**

**Nr.____ datë ____/____2024**

**PËR**
**MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË BUXHETIT PËR 12- MUJORIN VITI 2023,BASHKIA PËRMET**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", neni 48 " Monitorimi dhe zbatimi i buxhetit vendor", Ligji nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023" , i ndryshuar, Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkise,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë raportin e monitorimit të Buxhetit , për periudhën 12-mujore,viti 2023,për Bashkinë Përmet.

2. Ky vendim shpallet menjëherë dhe hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

**KRYETAR I BASHKISË**
**ALMA HOXHA**

Sheshi "Abdyl Frasheri", tel.+35581322254,e mail:info@bashkiapermet.gov.al

# RAPORTIM I ZBATIMIT TE BUXHETIT TE VITIT 2023 (JANAR-DHJETOR) BASHKIA PERMET



1.

I. **Buxheti i Bashkisë për Vitin 2023.**

Detajimi i buxhetit për vitin 2023, është bere bazuar ne ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar , ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin 68/2017 date 27.4.2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", ligjin 84/2022 " Per buxhetin e vitit 2023 " miratuar me VKB nr.99 date 15.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023, të Bashkisë Permet ",me ndryshime .

Programi Buxhetor i vitit 2023,parashikonte, një mbulim sa më të plotë ,të territorit, me shërbime publike cilësore ,me qellim përmirësimin e jetesës së qytetarëve; përmirësimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit te pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta; përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit; mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit; rritjen e investimeve , rehabilitimin dhe investimin e infrastrukturës banjëqësore, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij; përmirësimin e sistemit të edukimit , sigurimin e kushteve sa më dinjitoze për fëmijët dhe të rinjtë ,mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit; zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive; sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Permet;

Ky dokument ka përcaktuar 13 programe dhe nje seri funksionesh dhe aktivitetesh respektive per çdo funksion, prandaj është tregues më i mirë se si shpenzimet e planifikuara lidhen me veprimtaritë dhe projektet e planifikuara si dhe me Strategjinë e Zhvillimit dhe Planet Vendore që i mbështesin këto projekte

**Bashkia Permet, administron dhe menaxhon fondet, sipas 13 programeve të miratuara, të listuar dhe te permbledhura si me poshte me poshtë:**

1. Programi "Planifikim, menaxhim dhe administrim".
2. Programi "Infrastruktura rrugore".
3. Programi "Ujitja dhe kullimi".
4. Programi "Mjedisi dhe mbrojtja e pyjeve e kullotave".
5. Programi "Arsimi parauniversitar"dhe konviktet.
6. Programi "Kultura dhe aktivitet kulturore ".
7. Programi "Rinia dhe Sportet".
8. Programi " Emergjencat Civile"
9. Programi Kujdesi Per femijet ,Cerdhe
10. Programi Zhvillimi ekonomik Sherbime Publike
11. Programi Perfshirja Sociale
12. Programi Programi i arsimit parashkollor

Burimet e financimit te buxhetit të Bashkisë për vitin 2023, vijne nga 3 burime:

**1.Nga burimet e veta vendore,** ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, te ardhurat nga tarifat vendore te miratuara ne paketen fiskale te Bashkise Permet me VKB nr.98,dt.05.12.2022, te ardhura te tjera nga donatoret dhe te ardhura qe trashegohen nga viti 2022.

**2.Nga burimet qendrore,** ku përfshihen transferta e pakushtezuar, transferta specifike sektoriale për funksionet e reja, që i jane transferuar Bashkisë ,Transferta e pakushtezuar dhe sektoriale specifike e trasheguar dhe transferta e kushtëzuar.

**3.Fonde te BE dhe organizata te tjera jo fitim prurese**

## II. Realizimi i te ardhurave te Bashkisë nga burimet e veta vendore për 12-mujorin 2023.

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat e veta, taksat e ndara, tarifat vendore, te ardhurat te tjera . Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Gjatë 12/mujorit të vitit 2023, përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi të ardhurat e nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve.

Rëndësi e veçantë iu dha shtrytëzimit dhe vëmes në efiçencë të aseteve të veta, implementimit të proçedurave online e të thjeshta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arkëtimeve nëpërmjet politikave lehtësuese, taksave të ulta dhe rritjes së frymës se konkurrences së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të proçedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe biznesevesi partnerë të përbashkët të bashkisë.

Politikat e ngjashme për te gjendur sa më pranë taksapaguesit nëpërmjet taksave dhe tarifave të ulëta e në harmoni me shërbimin që ofrohet, si psh: dhënia e lehtësive fiskale për shtresat familjare në nevojë, taksa në minimumin e lejuar ligjor për tokën bujqesore, mundësia e arkëtimit në keste dhe pranë njësive administrative ku banojne etj. janë zbatuar dhe kanë rezultuar të suksesshme jo vetëm për zbutjen e vështirësive ekonomike për shtresa të veçanta të familjeve dhe reduktimin e papunësisë,por edhe për vetë rritjen e të ardhurave nga viti në vit.

Objektiv i rendesishem ka qene përditësimi i vazhdueshëm i regjistrave dhe kapaciteteve fiskale duke përfshirë gjithe territorin e bashkisë. Për këtë arsye, në bashkëpunim me Njësitë Administrative u koordinuan strukturat e konstatimeve në vend të këtyre kapaciteteve, u ushtruan verifikime te vazhdueshme në të gjitha njësitë administrative, duke vijuar me formalizimin e të dhënave me efekt arritjen e rezultate të mira në zërat kryesore të të ardhurave kryesisht kju per taksen e ndertesës pasi ishte viti I para I implementimit te ndryshimit te saj. Paralelisht janë ndjekur proçedurat e njoftimit brenda afatit, me vijimin e masave shtrenguese për subjektet debitore.

Si rezultat i masave të marra, si dhe i sensibilizimit të vazhdueshëm të taksapaguesve, te ardhurat janë realizuar duke përmbushur parashikimet e planifikuara..

Objektivi për sigurimin dhe rritjen e të ardhurave të realizuara mijë lekë, në krahasim me vitin e kaluar mije leke,pra nje rritje nga viti i kaluar me mije leke

Gjithashtu përgjatë periudhës është siguruar përafrimi i planit me nivelet e arkëtimeve, duke garantuar kështu të ardhurat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të veta te bashkisë.

Të ardhurat e veta u realizuan në proçes dhe bashkëpunim me gjithë administratën e bashkisë, me Njësitë Administrative, me Institucionet si agjencë tatimore, institucionet shtetërore etj.

Vijimi i këtij procesi bashkëpunues do mundësojë më tej sigurimin e të ardhurave për përmirësimin e vazhdueshem të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve te saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorittë bashkisë.

**Kategorizimi i të ardhurave**

- Taksat vendore:
  - Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, per ndërtesa, truje dhe toka bujqësore
  - Taksa e ndikimit në infrastrukture nga ndërtimet e reja
  - Taksa e fjetjes në hotel
  - Taksa e tabelës për qëllime reklamimi ose identifikimi
  - Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, biznes i vogël nga 5 milion deri ne 8 milion.
- Taksat e ndara
  - Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë.
  - Taksa vjetore e mjeteve të përdorura.
  - Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare
  - Te ardhura pjesore nga tatimi mbi të ardhurat personale
- Tarifat vendore
  - Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
  - Tarifa për ndriçimin publik
  - Tarifa për gjelbrimin
  - Tarifa të sherbimit administrative të bashkisë Permet.
  - Tarifa për parkimin e mjeteve e liçensuara dhe vendparkime publike
  - Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri
  - Tarifa për zënien e hapësirave publike
  - Tarifa nga Institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj.

- Të ardhura te tjera:
    - Të ardhura nga gjoba
    - Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve, zhdëmtime, shitja e mallrave dhe e sherbimeve etj
- Donacione/Sponsorizime

Të ardhurat nga burimet e veta vendore të Bashkise, 12 mujori i vitit 2023 000/lekë

| Nr. | Të ardhurat nga burimet e veta vendore | Plan 12-mujor 2023 | Realizimi 12-mujori 2023 | Realizimi % 12-mujor |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Të ardhurat nga taksat vendore | 31,608 | 26,671 | 84.3% |
| 2 | Të ardhurat nga tarifat vendore | 40,709 | 35,919 | 88.2% |
| 3. | Te ardhura nga donacionet ,etj. | 7,000 | 7,767 | 110.9% |
| | **TOTALI** | **79,317** | **70,357** | **88.7%** |

10

Të ardhurat nga burimet e veta vendore për 12mujorin e vitit 2023 u realizuan në vleren 70 357 mijë Lekë. Ato përfshijnë të ardhurat nga taksat, nga taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat dhe të ardhurat nga burime të tjera.

Niveli më i larte i arkëtimit është në muajin Tetor ,Nentor me afrimin e afatit të shlyerjes së detyrimit nga biznesi, si dhe ndjekjes se masave shtrënguese ndaj subjekteve debitore,si dhe derdhjeve te bera nga SHA Ujesjelles Permet.
Me i detajuar arketimi i te adhurave sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si me poshte :

| | LLOJET E TE ARDHURAVE | Plan viti 2023 | Realizimi Janar-Dhjetor 2023 | Krahasimi në % me planin Dhjetor 2023 |
|---|---|---|---|---|
| A. | TË ARDHURAT E VETA | 79317 | 70357 | 88.7% |
| A.1 | TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE | 31608 | 26671 | 84% |
| 1.1 | Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per BV | 109 | 286 | 282% |
| 1.1.0 | Te ardhura nga taksa mbi BV | | | |
| 1.2 | Te ardhura nga taksa mbi pasurine e paluajtshme | 12549 | 12328 | 98% |
| 1.2.1 | Te ardhura nga taksa mbi ndertesa | 9872 | 9251 | 94% |
| 1.2.1.1 | Ndertesa banimi | | | |
| 1.2.1.2 | Ndertesa jo banimi | | | |
| 1.2.2 | Te ardhura nga taksa mbi token bujqesore | 1818 | 1964 | 108% |
| 1.2.3 | Te ardhura nga taksa mbi truallin | 861 | 1113 | 129% |
| 1.3 | Te ardhura nga taksa e fjetjes ne hotel | 100 | 108 | 108% |
| 1.4 | Te ardhura nga taksa e ndikimit ne infrastrukture | 10728 | 3193 | 30% |
| 1.5 | Te ardhura nga taksa e tabeles | 296 | 380 | 128% |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| A.II | TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA | 7826 | 10078 | 133% |
| II.1 | Të ardhura nga taksa vjetore e qarkullimit te mjeteve | 3965 | 5648 | 142% |
| II.2 | Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë | 1449 | 201 | 14% |
| II.3 | Të ardhura nga taksa e rentës minerare | | | |
| II.4 | Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale | 2412 | 4527 | 188% |
| A.III | TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE | 30325 | 25828 | 85% |
| III.1 | Te ardhura nga tarifa e pastrimit, largimit të mbeturinave | 13200 | 14803 | 112% |
| III.1.1 | Te ardhura nga tarifë pastrimi nga Familje | | | |
| III.1.2 | Të ardhura nga tarife pastrimi nga Institucione | | | |
| III.1.3 | Të ardhura nga tarife pastrimi nga Biznesi | | | |
| III.2 | Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik | 4540 | 4359 | 96% |
| III.1.1 | Te ardhura nga tarifë për ndriçimin publik nga Familje | | | |
| III.1.2 | Te ardhura nga tarife ndriçimi publik nga Institucione | | | |
| III.1.3 | Të ardhura nga tarife ndriçimi publik nga Biznesi | | | |
| III.3 | Të ardhura nga tarifa për gjelbërimin | 1963 | 2080 | 106% |
| III.1.1 | Të ardhura nga tarifa per gjelbërimin nga Familje | | | |
| III.1.2 | Te ardhura nga tarifë gjelbërimi nga Institucione | | | |
| III.1.3 | Te ardhura nga tarife gjelbrimi nga Biznesi | | | |
| III.5 | Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ | 5822 | 2246 | 39% |
| III.1.1 | Nga tarifa administrative, kontroll territorit, AMTP etj. | | | |
| III.1.2 | Nga tarifa per vulosje veterinere te bagetive te therura | 0 | 0 | |
| III.1.3 | Nga Tarifat e licensimit te veprimtarive të transportit | 3000 | 255 | 9% |
| III.1.4 | Nga tarifa parkimi per mjetet | 352 | 63 | 18% |
| III.1.5 | Nga tarifë per dhenie lejesh per tregtimin e naftes | | | |
| III.1.6 | Nga tarifat regjistrimi e pyjeve dhe kullotave. | 1500 | 1278 | 85% |
| III.1.7 | Nga tarifat e shërbimeve per leje ndërtimi nga e MNZ | 120 | 102 | 85% |
| III.1.8 | Nga tarifa për zënien e hapësirave publike | 850 | 558 | 66% |
| III.1.9 | Nga tarifat ujore dhe përgjithësore | | | |
| III.1.10 | Nga dokumentat per tender, ankand etj | | | |
| III.1.11 | Nga tarifa të institucioneve te arsimit, kultures, sportit, etj | 4800 | 2340 | 49% |
| III.1.11 | Pallati sporti | | | |
| III.1.11 | Nga kopshtet | 4800 | 1466 | 31% |
| III.1.11 | Nga çerdhet | | 874 | |
| A.IV | TË ARDHURA TË TJERA | 10384 | 10091 | 97% |
| IV.1 | Të ardhura nga kundervajtjet administrative (Gjobat) | | | |
| IV.2 | Të ardhura nga dhënia me qira | 2112 | 0 | 0% |
| IV.3 | Te ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime | | 525 | |
| IV.4 | Të ardhura nga qera per troje | 3500 | 6027 | 172% |
| IV.7 | Të ardhura te tjera | 4772 | 3539 | 74% |
| | Detyrimet ujesjellesi | 24811 | 0 | 0 |
| A.V | TË ARDHURA NGA DONACIONET | 7000 | 7767 | |
| | Rimbursim nga EXPLORAL | | 959 | |

Në krahasim me realizimin e të njëjtës periudhë të vitit të kaluar, kemi një rritje të të ardhurave me ose mijë leke.

Në lidhje me planin 12 mujor të vitit 2023 të ardhurat janë realizuar 88.7%.

Zërat ndikues në mosrealizim janë taksa e ndikimit në infrastrukturë, si rezultat i numrit të ulët të aplikimeve për ndërtime të reja , etj
Grafikisht te ardhurat e realizuara per vitin 2023 jane si me poshte:



Grafiku i meposhtëm paraqet nivelin e realizimit të të ardhurave në lidhje me planin 12mujor për kategorite e taksave, taksave të ndara, tarifave dhe të ardhurave të tjera në lidhje.




| | Te ardhura nga taksat | Te ardhura nga taksa te ndara | Te ardhura nga tarifat | Te ardhura nga donacionet |
|---|---|---|---|---|
| Plan | 23782 | 7,826 | 40709 | 7,000 |
| Realizim | 16295 | 10376 | 35919 | 7,767 |

Shpenzimet per paga rreth 95% jane realizuar me burim financimi Burimet e Veta dhe me Transferte Specifike,dhe 92.3% me transferte te Kushtezuar.
Shpenzimet Operative rreth 69,2% jane realizuar me Burimet e veta dhe me Transferte Specifike
Shpenzimet per transferime jane realizuar me transferte te kushtezuar me rreth 66.7%.
Shpenzimet per investime rreth 46% jane realizuar me Burimet e Veta ,transferte specifike

Transferta e pakushtezuar dhe te ardhurat e veta vendore

Te ardhurat e veta përfshijnë transferten e pakushtezuar, te ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore dhe te ardhura nga burime te tjera. Këto burime të ardhurash, jane burimi kryesor i buxhetit te bashkise dhe zene 50.6% te totalit te buxhetit te planit te pergjithshem Bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Gjatë vitit 2023 përveç administrimit dhe dhënies së sherbimit ndaj qytetarëve në gjithe territorin e saj, bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi të ardhurat e nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve.

Transferta specifike

Ne vitin 2022 bashkia vazhdon te kryeje funksionet e transferuara me burim financimi transferten specifike.

- **Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar**

Në transfertën specifike te vitit 2023, janë akorduar fondet per personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmes të arsimit parauniversitar.

Per Arsimi parashkollor (kopshtet e fëmijëve), edukatore dhe punonjës në Qendrat Kulturore të Fëmijëve/punonjës mbështetës, janë alokuar fonde për paga dhe sigurime shoqërore per 34 punonjës të transferuar si dhe shpenzime operative ne vleren 36,958 mijë leke Bashkia Permet per nje cilesi me te mire ne kete sherbim nga te ardhurat e saj ka shtuar fonde per shpenzime operative per mirembajtjen e objekteve mesimore e ushqimit ne kopshtet me dreke ne vleren 1.500 mije leke .

- **Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MNZSH)**

Në transfertën specifike te vitit 2023, janë fondet për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit. Në keto fonde bëjnë pjese fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Shuma e alokuar bashke me transferten e trasheguar per vitin 2023,eshte 25.965 mijë lekë, numri i punonjesve 14

- **Rrugët rurale**

Në transfertën specifike të vitit 2023, janë alokuar fondet për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Për këte funksion për vitin 2023,i jane alokuar 7.917 mijë lekë. Bashkia Permet per nje cilesi me te mire ne kete sherbim nga te ardhurat e saj ka shtuar fonde per paga e sigurime shoqerore per punonjes dhe shpenzime operative dhe investime ne vleren 85.202 mije leke .

- **Administrimi i pyjeve**

Në transfertën specifike te vitit 2023, janë planifikuar fondet për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond perfshiheshin fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.Për këtë funksion për vitin 2023 ,jane alokuar 9,754 mijë leke, numri i punonjësve është 7.Bashkia Permet per nje cilesi me te mire ne kete sherbim nga te ardhurat e saj ka shtuar fonde per paga e sigurime shoqerore per 7punonjes ne vleren 4,860 mije leke .

- **Ujitja dhe Kullimi**

Në transfertën specifike të vitit 2023, jane planifikuar fondet për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond perfshiheshin fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative dhe investime .Për këtë funksion për vitin 2023 i jane alokuar 19.951 mijë leke. numri i punonjësve është 2. Bashkia Permet per nje cilesi me te mire ne kete sherbim nga te ardhurat e saj ka shtuar fonde per paga e sigurime shoqerore per 7 punonjes ne vleren 3.785 mije leke

- **Konviktet e arsimit parauniversitar**

Në transfertën specifike të vitit 2023, Bashkisë Permet i janë akorduar fonde për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë ishin te përfshira: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukatori), shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime. Fondi i alokuar për këtë funksion per vitin eshte 27,897 mijë lekë .

Realizimi i transfertes specifike ne total paraqitet si me poshte:

**Detyrimet e prapambetura të bashkisë Permet, te trasheguara nga zbatimi i Reformes Territorial**

Sipas përcaktimit në Udhëzimin e Ministrisë së Financave, detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet financiare të

përcaktuara nga një ligj/kontratë /marrëveshje /vendim gjykate i formës së prerë që mbeten te papaguara 60 ditë pas datës së

pecifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës, te cilat kanë lindur në njësitë

vetëqeverisjes vendore.

Procedura,eshte ne zbatim të reformes territoriale VKM nr 510, datë 10.06.2015 " Për miratimin e procedurave për transferimin e të

rejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në

njësnë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrative-territoriale"

Bashkia Permet raporton në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë per cdo tremujor per keto detyrime te prapambetura.ne fundin

muajit pasardhes

Detyrimi i mbetur është 30,119,149 leke. nga këto janë 2,346,886 lekë detyrime per shlyerje fatura te prapambetura para vitit 2007

15,395,657 leke detyrime per investime fatura te palikuiduara te cilat jane celur ne degen e thesarit me PBA 3vjecare ,nga fondet e

buxhetit te Bashkise, leke detyrim per vendime gjyqesore te palikuiduara 12,376.606 leke .

Realizimi i shpenzimeve sipas matricës së programeve. per vitin 2023 paraqitet si me poshte:

000/leke

| | | [illegible] | | | [illegible] | | | [illegible] | | | [illegible] | | | [illegible] | | | Total | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | [illegible] | [illegible] 2023 | [illegible] 2023 | Realizat 2023 | [illegible] 2023 | [illegible] 2023 | Realizat 2023 | [illegible] 2023 | [illegible] 2023 | Realizat 2023 | [illegible] 2023 | [illegible] 2023 | Realizat 2023 | [illegible] 2023 | [illegible] 2023 | Realizat 2023 | [illegible] 2023 | [illegible] 2023 | Realizat 2023 |
| [illegible] | [illegible] | 53312 | 155 | 51722 | 25300 | 3372 | 24700 | 0 | 0 | 0 | 0 | 172 | 172 | 302 | 0 | 45 | 79472 | 5528 | 75570 |
| [illegible] | [illegible] | 15067 | 2521 | 15652 | 2306 | 650 | 2299 | 0 | 0 | 0 | 3104 | 0 | 359 | 3036 | 480 | 0 | 23444 | 2521 | 18751 |
| [illegible] | [illegible] | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| [illegible] | [illegible] | 5853 | 420 | 5782 | 6620 | 0 | 4316 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 21574 | 0 | 11452 | 23730 | 720 | 21515 |
| [illegible] | [illegible] | 8080 | 1386 | 5798 | 5150 | 0 | 3237 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 13230 | 1384 | 11631 |
| [illegible] | [illegible] | 11085 | 3588 | 16535 | 4330 | 0 | 5114 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 68081 | 3157 | 34650 | 80496 | 522 | 58850 |
| [illegible] | [illegible] | 36361 | 3280 | 28364 | 6045 | 0 | 6909 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5414 | 0 | 3670 | 39820 | 3250 | 38570 |
| [illegible] | [illegible] | 1750 | 68 | 1779 | 120 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4000 | 0 | 3305 | 65620 | 511 | 0 | 70508 | 581 | 5584 |
| [illegible] | [illegible] | 6407 | 500 | 5850 | 501 | 200 | 654 | 0 | 0 | 0 | 1000 | 0 | 1000 | 6215 | 0 | 5534 | 14551 | 1003 | 14143 |
| [illegible] | [illegible] | 25320 | 1939 | 28416 | 7621 | 69 | 5127 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 37010 | 1449 | 33543 |
| [illegible] | [illegible] | 6457 | 932 | 5680 | 2496 | 30 | 1523 | 0 | 0 | 0 | 1000 | 0 | 1002 | 19133 | [illegible] | 14907 | 30685 | 362 | 26210 |
| [illegible] | [illegible] | 10070 | 557 | 8051 | 4527 | 0 | 1958 | 0 | 0 | 0 | 13130 | 0 | 2011 | 10512 | 4812 | 2433 | 31405 | 40 | 22573 |
| [illegible] | [illegible] | 17348 | 2354 | 16445 | 9750 | 0 | 4438 | 0 | 251 | 251 | 0 | 0 | 0 | 70950 | 4751 | 10850 | 87046 | 2354 | 10702 |
| [illegible] | [illegible] | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4081 | 0 | 1131 | 0 | 0 | 0 | 4081 | 0 | 1131 |
| TOTAL | | 200656 | 38146 | 207064 | 78054 | 6641 | 59115 | 0 | 251 | 251 | 13845 | 172 | 10638 | 200505 | 4085 | 97443 | 341760 | 20972 | 302352 |

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve" 2023

ne 000/leke

| Emri i Grupit | | Kodi i Grupit | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Shpenzimet e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore | | | | | | |
| Programet | | (1) Fakti | (2) PBA | (3) Buxheti Vjetor | (4) Buxheti Vjetor | (5) Buxheti Vjetor | (6) Fakti | (7)=(5)-(6) |
| Titulli | Emertimi | i vitit paraardhes Viti 2022 | Viti 2023 | Plan Fillestar Viti 2023 | Plan i Rishikuar Viti_2023 | Plani i Periudhes/progresiv | i Periudhes/progresiv | Diferenca |
| 0001 | Administrim,menaxhimi | 64,?97.0 | | 79 472.0 | 5.998.0 | 85.470 | 76,569 | 8.901.0 |
| 0002 | 5100 Pastrim | | | 37,946.0 | 2 354.0 | 40.300 | 33.783 | 6.517.0 |
| 0004 | 9120 Arsimi parashkollor | 32,271.0 | | 37,010.0 | 1.449.0 | 38.459 | 33,541 | 4.918.0 |
| 0005 | 9230 Arsimi parauniversitar | 12,063.0 | | 30 095.0 | 961.0 | 31.045 | 26,210 | 4.836.0 |
| 0006 | 4620.4530 Menezhimi rrugor | 38.360.0 | | 90 496.0 | 622.0 | 91.118 | 56.999 | 34.119.0 |
| 0007 | 4130 Zhvillimi ekonomik | 1 000.0 | | | 0.0 | | | 0.0 |
| 0008 | 6260.Sherbime publike | 51 447.0 | | 38,920.0 | 3 280.0 | 42 200 | 38 978 | 3,222.0 |
| 0009 | 8220 Kultura | 19,731.0 | | 14 553.0 | 1 003.0 | 15 556 | 14 145 | 1,411.0 |
| 0010 | 10430Sherbimi social | 9 605.0 | | 31 408.0 | 49.0 | 31.458 | 23.535 | 7,921.0 |
| 0011 | 4240 Bordi i kullimit | 8.750.0 | | 23,736.0 | 720.0 | 24 456 | 21 514 | 2,942.0 |
| 0012 | 4260 Administrimi i pyjeve | 9.457.0 | | 13 220.0 | 1.383.0 | 14.613 | 11,430 | 3,183.0 |
| 0013 | 3260,MNZ | 15.558.0 | | 23.444.0 | 2,521.0 | 25.965 | 18.611 | 7,364.0 |
| 0014 | 8120,Sportet | 5.520.0 | | 70.589.0 | 900.0 | 71.589 | 5.684 | 65,905.0 |
| 0015 | 4920 Transporte o te tjera | 2.353.0 | | 4,581.0 | 0.0 | 4.581 | 1.381 | 3,200.0 |
| Totali i Shpenzimeve të Njësisë | | 268,922.0 | 0.0 | 495,790.0 | 21,019.0 | 516,809.0 | 362,380.0 | 154,429.0 |
| Totali | | 268,922.0 | 0.0 | 495,790.0 | 21,019.0 | 516,809.0 | 362,380.0 | 154,429.0 |

| Kryetari i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore | Emri | Alma HOXHA |
|---|---|---|
| | Firma | |
| | Data | |

1. Programi i Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim,Administrim)

Hyrje

Programi i administratës vendore përcakton menaxhimin dhe mbështetjen administrative për programet e politikat e zhvillimit

**Qeverisja jonë lokale do të bazohet në parimet e sundimit te ligjit, përgjegjësisë, llogaridhënies, besimit, transparencës, efektivitetit, efikasitetit, partneritetit dhe koherencës.**

Ndërkohë se qeverisja e mirë ndërlidhet me aftesine e Bashkisë për të siguruar shërbimin më të mirë për komunitetin, çdo anëtar është aktiv për te dhënë kontributin e tij. Prandaj, për ne ekziston një nevojë e vazhdueshme që Bashkia të veprojë si lehtësuese duke iu mirë qytetarëve:

- drejt të menduarit strategjik,
- duke i përfshirë ata në çështjet e pushtetit lokal,
- duke i bërë partnerë në zgjidhjen e problemeve

Politikat e vazhdueshme, e cila do te zbatohet nga administrata e bashkisë së Përmetit do të jenë:

I. Një strukturë menaxhuese cilësore, duke krijuar mundësine dhe lehtesinë për perthithjen e burimeve njerëzore profesionale dhe në funksion te zbatimit te qëllimeve

dhe objektivave të Bashkisë per ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

II. Përfshirja e qytetarëve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, në proceset vendimmarrëse me qëllim krijimin ose përmirësimin e politikave publike, procedurave dhe praktikave lokale në favor të krijimit mirëqenies së qytetarëve.

III. Dixhitalizmi i administratës publike është dhe do të mbetet një nga prioritetet tona në kuadër të programit te administratës vendore

Ne jemi të angazhuar për të shtuar dhe promovuar shërbimet elektronike për qytetarët, biznesin dhe administraten. Prioritet do te jetë rritja e transparencës dhe përmirësimi i sherbimeve në administraten publike vendore.

**Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje te objektivit FI.O2 paraqiten sipas tabeles me poshte :**

në 000/lekë

| Bashkia | Permet | | | | | Kodi i Grupit / Njësisë Vendore | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Programi | 1110 | | | | | Kodi i Programit | |
| Art. | Emërtimi | (1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2022 | (2) PBA Plan Viti 2023 | (3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023 | (4) Buxheti Vjetor Plani i Rishikuar Viti_2023 | (5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhës së progresit | (6) Fakti i Periudhës së progresit | (7)=(6)-(5) Diferenca |
| 600 | Paga | 37265 | | 45655 | 415 | 46072 | 44316 | 1756 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 6255 | | 7394 | 571 | 7965 | 7407 | 558 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 17196 | | 25290 | 5572 | 30862 | 24930 | 9332 |
| 603 | Subvencione | | | | 0 | | | 0 |
| 604 | Transferta Korente të Brendshme | | | | 0 | | | 0 |
| 605 | Transferta Korente të Huaja | | | | 0 | | | 0 |
| 606 | Transf. për Buxh. Fam. & Individ | 3304 | | | 172 | 172 | 172 | 0 |
| Nën-Totali | Shpenzime Korrente | 64130 | 0 | 78172 | 5899 | [illegible] | 76525 | 8846 |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | | | | 0 | | | 0 |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 61 | | 300 | 0 | 300 | 43 | 255 |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | | 0 |
| Nën-Totali | Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm | 61 | 0 | 300 | 0 | 300 | 46 | 255 |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | | | | 0 | | | 0 |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | | | | 0 | | | 0 |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | | 0 |
| Nën-Totali | Shpenzime Kapitale me financim të huaj | | | | 0 | | | 0 |
| Totali | Shpenzime Kapitale | 61 | 0 | 300 | 0 | 300 | 45 | 255 |
| [illegible] | | 64197 | | 78472 | 5899 | [illegible] | 76610 | 9901 |

**Realizimi i shpenzimeve për programin P1. Administratën Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim).**

Deri me datë 31.12.2023 janë likujduar në total 75,570 mijë lekë nga këto: paga dhe sigurime shoqërore 51,723 mijë lekë , shpenzime operative ne shumën 24,630 mijë lekë, investime ne shumën 45 mijë leke,Transferta te punonjesit 172 mije leke

| Programi P1 | Paga + Sigurime | Shpenzime Operative | Transferta | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| Plani 12-mujor 2023 | 54,037 | 30,962 | 172 | 300 | 85,471 |
| Realizimi 12-mujori 2023 | 51,723 | 24,630 | 172 | 45 | |

**Total fakt 75,570 leke**

**P2.Infrastruktura Rrugore**

**Hyrje**

Krijimi i territorit te ri administrativ te bashkisë eshte duke përfshirë qytetin e Permetit dhe fshatrat e 4 njësive administrative te tjera në programin e infrastruktures rrugore si funksion i veti do të jetë ndërtimi, mirëmbajtja dhe rehabilitimi i rrugëve vendore, trotuareve dhe sheshevë publike të tij.

**Politikat e zhvillimit**

Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane dhe infrastrukturës rrugore rurale duke mundësuar akses më të mirë të tyre në sistemin e infrastrukturës rrugore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Programi i infrastrukturës rrugore, bazohet në 2 politika themelore :

Përmirësimin e mjedisit urban dhe rural me standartet e duhura ne shërbim të komunitetit.

**Rritjen e cilësisë së jetës së banorëve.**

| Bashkia | Permet | | | | | Kodi i Grupit i Njësisë Vendore | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Programi | 4530+4520 | | | | | Kodi i Programit | ..... |
| Art. | Emertimi | -1 Fakti i vitit paraardhes Viti 2022 | -2 PBA Plan Viti __ 2023 | -3 Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti ___2023_____ | -4 Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti_2023______ | -5 Buxheti Vjetor Plani Periudhes/progresiv | -6 Fakti Periudhes/progresiv | (7)=(5)-(6) Diferenca |
| 600 | Paga | 17903 | | 15631 | 3214 | 19845 | 15884 | 2961 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 2722 | | 2464 | 595 | 3059 | 2651 | 408 |
| 602 | Mallra dhe Sherbime te Tjera | 3235 | | 4320 | 0 | 4320 | 3314 | 506 |
| 603 | Subvencione | | | | 0 | | | 0 |
| 604 | Transferta Korrente te Brendshme | | | | 0 | | | 0 |
| 605 | Transferta Korrente te Huaja | | | | 0 | | | 0 |
| 606 | Trans per Buxh. Fam & Individ | | | | 0 | | | 0 |
| Nen-Totali | Shpenzime Korrente | 18380 | 0 | 22415 | 3809 | 25224 | 22349 | 2875 |
| 230 | Kapitale te Patrupëzuara | | | | 0 | | | 0 |
| 231 | Kapitale te Trupëzuara | 18000 | | 68081 | -3187 | 64894 | 34650 | 30244 |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | | 0 |
| Nen-Totali | Shpenzime Kapitale me financim te brendshem | 18000 | 0 | 68081 | 3187 | 64894 | 34650 | 30244 |
| 230 | Kapitale te Patrupëzuara | | | | 0 | | | 0 |
| 231 | Kapitale te Trupëzuara | | | | 0 | | | 0 |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | | 0 |
| Nen-Totali | Shpenzime Kapitale me financim te huaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | Shpenzime Kapitale | 18000 | 0 | 68081 | -3187 | 64894 | 34650 | 30244 |
| Totali Korrente + Kapitale | | 36350 | 0 | 90496 | 622 | 91118 | 56999 | 34119 |

ër vitin 2023, jane percaktuar objektiva të qartë për punën tonë në përmbushjeve të detyrave funksionale. Këto objektiva janë akordësuar me organizatat e shoqërisë Civile, Institucionet në varësi të Bashkisë Permet .

Funksionet:

F1. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, shesheve publike vendoreurave etj

F1.O1.Mirembajtja e rrugëve dhe shesheve urbane;

| Situata e synuar 2023 Objektivat | Realizimi i objektivave 12-mujori 2023 | Realizimi i produkteve 12 – mujori 2023 |
|---|---|---|
| Kryerja e punimeve të mirëmbajtjes së rrugëve te sheshëve në Qytet,ne NJA mirembajtje urash etj. | Janë kryer punime mirëmbajtje të rrugëve si me poshtë: | Është përfunduar faza e punimeve për mirëmbajtjen e rrugëve rurale dhe shesheve të qytetit |

Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1

| Aktiviteti | Buxheti ne mije leke | Realizimi 12-mujori 2023 |
|---|---|---|
| | | në mijë |
| P1.F1.O1.A1 Mirembajtje rruge rurale ne NJA fonde te trasferuara . | 2,682 | 2,427 |
| U sistemuan 180 km rruge rurale ne te 4 Njesite Administrative ,duke nderhyre me te gjitha mjetet e renda .Vlera e mesiperme eshte vlera per karburant qe eshte harxhuar per sistemimin e rrugeve . | | |

F1.O2. Rikonstruksion rrugë dhe sheshe urbane

| Situata e synuar 2023<br>Objektivat | Realizimi i objektivave 12-mujori 2023 | Realizimi i produkteve 12 - mujori 2023 |
|---|---|---|
| Sistemim asfaltim rruge te ndryshme te fshatrave Kutal,Kosine ,Zhepe,Dracove | • Jane mbyllur punimet sipas kontrates se lidhur me firmen fituese"Fito-94" | Jane realizuar punimet e percaktuara ne objektiv. |

Aktivitetet dhe projektet që planifikohen ne përmbushje të objektivit F1.O2

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë | Realizimi 12-mujori IV-rë 2023 në mijë lekë |
|---|---|---|
| P3.F1.O2.Sistemim Asfaltim ne rruge te ndryshme te qytetit dhe NJA | 18,531 | 5,335 |
| P3.F1.O2.Sistemim Asfaltim rruga e spitalit Varezat publike | 46,363 | 29,318 |

**P1.O4. Permiresimi i rrjetit te rrugeve rurale duke siguruar lidhjen e te gjitha qendrave te banuara me rrjetin rrugor urban dhe kombetar.**

| Situata e synuar 2023 Objektivat | Realizimi i objektivave 12 - mujori 2023 | Realizimi i produkteve 12 – mujori 2023 |
|---|---|---|
| Mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrugëve, në pronësi të bashkisë. | Në proces zbatimi | Në proces zbatimi |
| Përmirësimi i infrastrukturës rrugore si dhe te rritje e aksesit ndaj shërbimeve bazë në zonat rurale.<br><br>Reduktim i kostove per realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes nëpërmjet rritjes së kapaciteteve teknologjike dhe përdorimit të fuqisë punëtore të njësive administrative. Mirëmbajtja e 180 km rruge. Numri i rrugëve në Njësi Administrative | Identitifikimi i problematikave në NjA. Hartimi i preventivave, dokumentacionit teknik dhe plani i ndërhyrjeve, për realizimin e procedurave të prokurimit. | |

**Realizimi i shpenzimeve për programin P2. Infrastruktura Rrugore 000/lekë.**

| Programi P2 | Paga + Sigurime | Shpenzime Operative | Transferta | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| **Plani 12-mujor 2023** | **21,904** | **4,320** | **0** | **64,894** | **91,118** |
| **Realizimi 12-mujorit të 2023** | **18,535** | **3,814** | **0** | **34,650** | **56,999** |

**P3. Shërbimet Publike**

**1.Hyrje**

Programi i ofrimit të shërbimeve publike qytetarëve, bizneseve dhe të gjithë komunitetit në të gjithë territorin administrative të Bashkisë përbën një nga kolonat kryesore të programit buxhetor. Ky program përmban shërbimet më jetike për komunitetin siç janë:

a) mirëmbajtja dhe administrimi i siperfaqeve të gjelberta,
b) mirëmbajtja e varrezave publike dhe krijimi i kushteve sipas standarteve për shërbimin funeral.
c) mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtja nga përmbytjet në zonat e banuara,
d) shërbimi i dekorit publik dhe ndriçimi i mjediseve publike,

Shërbimet publike, për nga rëndësia e tyre, ndikojnë direkt në cilësinë e jeteses së qytetarëve dhe janë një parakusht për zhvillimin social ekonomik për të gjithë territorin e Bashkisë Permet

## 2. Politikat e zhvillimit

Programi i shërbimeve publike, bazohet në tre politika themelore :
Ofrimi i shërbimeve publike cilësore për përmirësimin e jetesës së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit.

Rritja e e eficensës dhe efektivitetit te shërbimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm te teknologjisë si dhe zgjerimit te shërbimit.

Rritja e transparencës në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, duke siguruar pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit dhe te monitorimit, për ta orientuar ate sipas nevojave të tyre.

Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit FLOL

| Bashkia | Pemrot | | | | | | Kodi i Grupit i Njësisë Vendore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Programi | 6260 sherbimet publike | | | | | | Kodi i Programi |
| Art. | Emertimi | -1 Fakti i vitit paraardhes Viti 2022 | -2 PBA Plan Viti ___2023___ | -3 Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti ___2023_____ | -4 Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti_2023_____ | -5 Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv | -6 Fakti i Periudhes/progre |
| 600 | Paga | 33702 | | 22916 | 2862 | 25778 | 24486 |
| 601 | Sigurime Shoqerore | 5633 | | 3645 | 418 | 4063 | 3898 |
| 602 | Mallra dhe Sherbime te Tjera | 9355 | | 6945 | 0 | 6945 | 6939 |
| 603 | Subvencione | | | | 0 | | |
| 604 | Transferta Korente te Brendshme | | | | 0 | | |
| 605 | Transferta Korente te Huaja | | | | 0 | | |
| 606 | Trans per Bux. Fam. & individ | 1750 | | | 0 | | |
| Nen-Totali | Shpenzime Korrente | 50144 | 0 | 33506 | 3280 | 36786 | 35303 |
| 230 | Kapitale te Patrupezuara | 1277 | | | 0 | | |
| 231 | Kapitale te Trupezuara | 28 | | 5414 | 0 | 5414 | 3878 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | |
| Nen - Totali | ***Shpenzime Kapitale me financim te brendshem*** | 1303 | 0 | 5414 | 0 | 5414 | 3676 |
| 230 | Kapitale te Patrupëzuara | | | | 0 | | |
| 231 | Kapitale te Trupëzuara | | | | 0 | | |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | |
| Nen - Totali | ***Shpenzime Kapitale me financim te huaj*** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Totali** | **Shpenzime Kapitale** | **1303** | **0** | **5414** | 0 | **5414** | **3676** |
| **Totali (korrente + Kapitale)** | | **31447** | **0** | **36820** | 3280 | **42250** | **38879** |

F. Shërbimin e dekorit publik

**F.O1. Shtimi i aktiviteteve festive që kanë nevojë për dekorim, duke ruajtur traditën dhe kulturën tonë**

| **Situata e synuar 2023 Objektivat** | **Realizimi i objektivave 12-mujorit 2023** | **Realizimi i produkteve 12 mujorit 202** |
|---|---|---|
| Krijimi i dekorit në të gjithë sheshet dhe rrugët kryesore në zonat urbane; | Dekori realizohet në 6-mujorin e II-të, me rastin e festave tradicionale kombëtare dhe të Fundvitit. | Pagese dekori viti aktual |

Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F.O1

| **Aktiviteti** | **Buxheti në mijë lekë** | **Realizimi 12-mujorit 2023 në mijë lekë** |
|---|---|---|
| **P3.F.O1.A1** Shtimi i aktiviteteve festive që kanë nevojë për dekorim, duke ruajtur traditën dhe kulturën tonë, | **500** | **331** |

F8. Ndriçimi i mjediseve publike

**F8.O1. Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit të ndriçimit**

**Situata e synuar 2023** **Realizimi i objektivave** **Realizimi i produkteve 12– mujorit**

| Objektivat | 12-mujorit 2023 | 2023 |
|---|---|---|
| Siperfaqja totale e rrugeve dhe e rrugor. shesheve te ndricuara 55.360 M2. | Eshte mirembajtur i gjithe rrjeti i ndriçimit rrugor ne qytete dhe nje pjese e NJA. | Mbajtja ne efiçence e ndriçimit |
| Siperfaqet e lulishteve te ndricuara ndriçimit te Me investime te reja nga ne 7,000 m2.. | Mirembajtje e ndricimit te lulishteve ekzistuese.Zgjerimi i siperfaqes ne varesi te realizimit te investimeve te reja. | Mbajtja ne efiçence e lulishteve ekzistuese. |
| Rehabilitim dhe mirembajtje e ndriçimit te lulishteve ekzistuese. | | Ura Karburant "Roselia"<br>❖ Ura Karburant "Kastrati"<br>❖ Pedonale<br>❖ Lulishte kryesore<br>❖ Ura deri te Guri I Qytetit<br>❖ Rruga kryesore Qender-Guri i Qytetit<br>❖ Kryqezim komisariati Permet |
| Mirembajtje e ndriçuesva te ndriçimit Zakonshem 1.000 ndriçues. materiale vitit. | Mirembajtje e ndricuesva te zakonshem ekzistues | Mbajtja ne efiçence e rrugor duke siguruar baze te nevojshme gjate gjithe |
| Ofrimi i sherbimit te mirembajtjes ndriçimit se ndriçimit 3 Nj.Administrative dhe ndertimi i linjave te reja me e fshatrave,Badlonje,Bodar.prioritet ne zonat e populluara. | Mirembajtje e gjithe rrjetit te ndriçimit rrugor. | Mbajtja ne efiçence e |

Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F8.O1

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë | Realizimi 12-mujorit 2023 në mijë lekë |
|---|---|---|
| **P3.F8.O1.A1** Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit të ndriçimit | 4,500 | 4,084 |

Realizimi i shpenzimeve për programin **P3. Shërbimet Publike**
000/lekë viti 2023

| Programi P4 | Paga + Sigurime | Shpenzime Operative | Subvensioni | Transferta | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Plani 2023** | 29,841 | 6,945 | 0 | 0 | 5,414 | **42,200** |
| **Realizimi 12-** | 28,364 | 6,939 | 0 | 0 | 3,676 | 38,979 |

mujorit 2023

**P4.Bujqësia,Zhvillimi Rural**

**Hyrje**

Me delegimin e funksioneve te reja Bashkia permet ka trashëguar kanale ujitëse 63 km nga këto funksional 32 km dhe jo funksional 31 km ndërsa kanale kulluese gjithsej 50.5 km nga këto 26 km kanale të para dhe 24.5 km kanale të dyta kullues në pjesën më të madhe të tyre të papastruar prej vitesh.Eshte rehabilituar dhe 1 km kanal nepermjet fondeve te investimeve te ardhura dy vitet e fundit Kete vit u jane shtuar rehabilitimit te veprava ujitese dhe Ndertimi i kanalit ujites Piskove .Rikonstruksioni i rezervuarit Pacomit Diga ,vepra keto me afat ndertimi dhe likuidimi brenda vitit 2023-2024.

**Politikat e zhvillimit**

Programi i Bujqesisë,Zhvillimit Rural ka këto politika zhvillimi :

**Mbështetja për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe rritjen e shumëllojshmërisë së veprimtarive bujqësore dhe ekonomike në zonat rurale .**

**Mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e saj në për mjet projekteve, që fuqizojnë përdorimin e qëndrueshëm të tokave bujqesore si dhe të kategorive të resorseve të tjera.**

**Rehabilitimi i rrjetit kullues dhe vaditës ekzistues.**

**Dhe zgjerimi i tyre në te gjithë territorin që mbulon Bashkia Permet.**

**Funksionet:**

**F1.** Administrimi,shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit
**F1.O1. Përmirësimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit.**

| **Situata e synuar 2023 Objektiva t** | **Realizimi i objektivave 12-mujori 2023** | **Realizimi i produkteve 12 – mujori 2023** |
|---|---|---|
| **-32 km kanale ujitës të mirëmbajtur dhe të përmirësuar**<br><br>**-50,5 km kanale kullues të mirëmbajtur dhe të përmirësuar;**<br>**-275 Ha tokë në total në situatë të përmirësuar përsa i** | Janë mirëmbajtur dhe përmirësuar gjithsejt 32 km kanale ujitëse<br><br>Jane mirembajtur dhe permiresuar kanale te para kullues 26 km ,24.5 km kanale te dyta kulluese | Është përmirësuar ujitja në një sipërfaqe toke bujqësore në një total prej rreth 275 Ha.<br>Nderhyrjet ne sistemin kullues te para dhe dytesor ne Nj.A |

**Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1O**

| **Aktiviteti** | **Buxheti në mijë leke** | **Realizimi 12-mujori 2023 në mijë lekë** |
|---|---|---|
| **P7.F1.O1.Paga dhe sigurime shoqerore** | 6,322 | 5,783 |
| **P7.F1.O1.A5** Pastrimi kanalesh kulluese dhe ujitëse në Nj.A. | 6.620 | 4,280 |
| **P7.F1.O1** Investimet | 11,514 | 11,452 |
| TOTALI | **24,456** | **21,515** |

| Bashkia | Pirmet | | | | | Kodi i Grupit / Njësisë Vendore | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Programi | 4240 | | | | | Kodi i Programit | ... |

| Art. | Emertimi | 1<br>Fakt<br>i vitit paraardhes<br>Viti 2021 | 2<br>PBA<br>Plan<br>Viti __ 2023 | 3<br>Buxheti Vjetor<br>Plan Fillestar Viti 2022 ____ | 4<br>Buxheti Vjetor<br>Plan i Rishikuar Viti_2022 ____ | 5<br>Buxheti Vjetor<br>Plani - Perudhesi programit | 6<br>Fakti<br>i<br>Perudhesi programit | (7)=(6)-(5)<br>Diferenca |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 600 | Paga | 4107 | | 4034 | 808 | 5442 | 4965 | 485 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 791 | | 788 | 112 | 850 | 824 | 50 |
| 602 | Mallra dhe Sherbime te Tjera | 3945 | | 6820 | 0 | 6620 | 4280 | 2340 |
| 603 | Subvencion | | | | 0 | | | 0 |
| 604 | Transferta Korente te Brendshme | | | | 0 | | | 0 |
| 605 | Transferta Korente te Huaja | | | | 0 | | | 0 |
| 606 | Trans per Buxh. Fam & Individ | | | | 0 | | | 0 |
| Nen Totali | Shpenzime Korrente | 8763 | 0 | 12272 | 720 | 12942 | 10067 | 2879 |
| 230 | Kapitale te Pa-prekshme | | | | 0 | | | 0 |
| 231 | Kapitale te Trupëzuara | | | 11514 | 0 | 11514 | 11452 | 62 |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | | 0 |
| Nen Totali | Shpenzime Kapitale me financim te brendshem | 0 | 0 | 11514 | 0 | 11514 | 11452 | 62 |
| 230 | Kapitale te Paprekshme | | | | 0 | | | 0 |
| 231 | Kapitale te Trupëzuara | | | | 0 | | | 0 |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | | 0 |
| Nen Totali | Shpenzime Kapitale me financim te huaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | Shpenzime Kapitale | [illegible] | [illegible] | 11514 | 0 | 11514 | 11452 | 62 |
| Totali Shpenzime Korrente + Kapitale | | [illegible] | [illegible] | [illegible] | 720 | [illegible] | [illegible] | 2941 |

**P5. Mjedisi dhe Mbrojtja e Pyjeve dhe Kullotave**

**5. Hyrje**

Pyjet dhe kullotat e Bashkisë Permet zenë një sipertaqe prej rreth 17,711 ha. Ku rreth 10,374 ha jane pyje , rreth 7,334 ha jane kullotë dhe sipërfaqja tjetër është bimësi pyjore, inproduktive etj. Pyjet kontribuojnë në mënyrë efektive në zhvillimin e qëndrueshëm, nepërmjet sigurimit të mirëqenies njerëzore, sigurojnë një mjedis të shëndetshëm dhe mbështesin zhvillimin ekonomik të zonës në tërësi. Potenciali unik i pyjeve mbështet një ekonomi të gjelhër, cilësinë e jetës dhe ndikon në zbutjen e ndryshimeve klimatike.
Sfida për të realizuar këtë balancë të qëndrueshmë mjedisore është e madhe dhe e vështirë referuar edhe larmishmërisë së territorit dhe problematikave që mban sejcili sistem territorial

**6. Politikat e zhvillimit**

Programi i Mjedisit dhe Mrojtjes së Pyjeve e Kullotave mbështetet në këto politika themelore :

Mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetareve, përmes bashkëpunimit me komunitetin e Bashkisë e shoqerinë civile. Rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit gjithperfshires ne fushen e mbrojtjes se natyres ne bashkepunim me te gjitha institucionet rajonale dhe jo vetem per ndalimin e humbjes se biodiversitetit por edhe permiresimit te statusit te tyre.

Mbrojtjen dhe përmiresimin e mjedisit ujor, të ujerave sipërfaqesore, lumenjve dhe liqenit, ujrave nëntokesore etj. Shfrytëzimin racional të burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë te tyre sipas qëllimeve të përdorimit si edhe mbrojtjen e tyre nga ndotja.

Zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve pyjore dhe kullosore, që të sigurojnë ekuilibrin biologjik të ekosistemeve pyjore, ruajtjen e sipërfaqeve pyjore, rritjen e prodhimtarisë dhe aftesisë ripertritëse të pyjeve, parandalimin e degradimit të mëtejshëm të tokës.

**Funksionet:**

**F1. Zbatimin e dispozitave ligjore nëpërmjet strategjive, programeve dhe projekteve të cilat synojnë përmiresimin e vazhdueshëm të mjedisit dhe të përbërësve të tij.**

**F2.O2. Bashkëpunimi me institucionet e arsimit parauniversitar mbi promovimin e zhvillimit e qëndrueshëm të mjedisit në Bashkinë Permet.**

| Situata e synuar 2023 | Realizimi i objektivave 12-mujori 2023 | Realizimi i produkteve 12-mujori 2023 |
|---|---|---|
| Realizimi i 5 takime sensibilizues e per | Realizimi i 3 takimeve ditë të sensibilizuese | Jane realizuar 3 takime ne kuader te "dites se tokes" date 22 prill 2023,me nxenes te 2 |

shkollave 9- vjecare te qytetit dhe nxenes te shkolles se mesme "Sami Frasheri"

vecanta në kuadër të mbrojtjes së mjedisit.

" dita e tokës" dhe "dita e mjedisit".

Aktivitet ne kuader te dites se mjedisit , me nxenes te 3 shkollave te qytetit .

F3. Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

F3.O1. Sigurimi i mbrojtjes për qeverisjen e qëndrueshme dhe kontrollin e mire administrimit të fondit pyjor dhe kullosor brenda territorit administrativ të bashkisë.

**Realizimi i shpenzimeve për programin P8. Mjedisi dhe Mbrojtja e Pyjeve dhe Kullotave 000/lekë**

| Programi P5 | | Paga Sigarime | + Shpenzime Operative | Transferime | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Plani 2023 | | 9,464 | 5,150 | 0 | 0 | 14,614 |
| Realizimi | 12- | 8,196 | 3,235 | 0 | 0 | 11,431 |

| Buxheti | Fermes | | | | | Kodi i Grupit / Njesisë Vendore | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Programi | 4280 | | | | | Kodi i Programit | |

| Art. | Emertimi | -1 Fakt i vitit paraardhes Viti 2022 | -2 PBA Plan Viti ___2023___ | -3 Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti ___2023___ | -4 Buxheti Vjetor Plani Rishikuar Viti_2023_____ | -5 Buxheti Vjetor Plani i Periudhes progresive | -6 Fakt i Periudhes progresive | (7)=(6)-(5) Diferenca |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 600 | Paga | 5850 | | 6971 | 1175 | 2143 | 7021 | 1123 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 921 | | 1109 | 209 | 1315 | 1173 | 145 |
| 602 | Mallra dhe Sherbime te Tjera | 1230 | | 5150 | 0 | 5150 | 3295 | 1815 |
| 603 | Subvencion e | | | | 0 | | | 0 |
| 604 | Transferta Korente te brendshme | | | | 0 | | | 0 |
| 605 | Transferta Korente te huaja | | | | 0 | | | 0 |
| 606 | Trans per Buxh. Fam. & Individ | | | | 0 | | | 0 |
| Nen-Totali | Shpenzime Korrente | 8782 | 0 | 13230 | 1384 | 14624 | 11461 | 3163 |
| 230 | Kapitale te Patrupezuar a | | | | 0 | | | 0 |
| 231 | Kapitale te Trupezuara | 1285 | | | 0 | | | 0 |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | | 0 |
| Nen-Totali | Shpenzime Kapitale me financim te brendshem | 1285 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 230 | Kapitale të Patrupezuar a | | | | 0 | | | 0 |
| 231 | Kapitale te trupezuara | | | | 0 | | | 0 |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | | 0 |
| Nen-Totali | Shpenzime Kapitale me financim te huaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | Shpenzime Kapitale | 1285 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali (korrente + kapitale) | | [illegible] | 0 | 13230 | 1384 | 14624 | 11461 | 3163 |

P.6 Arsimi parauniversitar dhe edukimi

7. Hyrje

Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit tonë. Shkolla duhet t'i mundësojë çdo fëmije që të ketë rezultate të kënaqshme në mësime, te jete i sigurtë, i shëndetshem dhe aktiv në jetën komunitare.

Me ndarjen e re territoriale, Bashkia Permet duhet të sigurojë mirëmbajtjen e një numri të madh institucionesh arsimore per 5 njesitë administrative. (5 shkolla qe kane dhe shkolla te tjera ne juridiksionin e tyre , 10 kopshte, 1 konvikt), që kërkojnë një vëmendje të veçantë. Synimi ynë është menaxhimi me efikasitet i fondeve për arsimin dhe krijimi i mundësive për një zhvillim e shfrytëzim cilësor të infrastrukturës së institucioneve arsimore në të gjithë territorin e Bashkise Permet. Në kuadër të reformës së re administrative të qeverisjes vendore janë pjesë e këtij programi edhe delegimi i funksioneve të reja si: Arsimi parashkollor (kopshtet e fëmijëve), edukatorë dhe punonjes në Qendrat Kulturore të Fëmijëve. Punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin bazë, arsimin 9-vjecar (Parashkollor dhe të Qendres Kulturore), punonjësit e shërbimeve mbështetëse te Arsimit te Mesëm.

8. Politikat e zhvillimit

Sigurimi i shërbimeve mbështetëse, cilësore në te gjithë territorin, për institucionet e edukimit parauniversitar dhe atij parashkollor gjatë procesit të realizimit të programit mësimor vjetor.

Përmirësimi i sistemeve të edukimit dhe trajnimit profesional dhe ndërlidhja e politikës arsimore me politikën social-ekonomike.

**Funksionet:**

**F1.Rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar.**

| Situata e synuar 2023 | Realizimi i objektivave 2023 | Realizimi i produkteve 12-mujori 2023 |
|---|---|---|
| **Te kryhen te gjitha pagesat per personelin edukativ dhe personelin ndihmes ne shkollat,kopshtet e Bashkise;** | Jane realizuar te gjitha pagesat per personel ndihmes ne shkollat e kopshtet e Bashkise se Permetit dhe konvikteve | Kane marre pagesat personeli ndihmes ne shkollat kopshtet dhe konviktet |
| **Sigurimi i funksionimit normal te objekteve arsimore(shkolla\konvikte),nepermjet sherbimeve mbeshtetese** | Permiresimi i kushteve me ane te sigurimit te sherbimeve baze me qellim funksionimin sa me normal te objekteve shkollore | Realizimin e pagesave te sherbimeve,energji elektrike,uje,te objekteve shkollore dhe internet per QKF |

| | | |
|---|---|---|
| **Sigurimi i materialeve baze per funksionimin e sherbimeve mbeshtetese** | Permiresimi i kushteve me ane te sigurimit te materialeve per sherbimet mbeshtetese,me qellim funksionimin sa me normal te objekteve shkollore . | Jane realizuar blerjet e materialeve hidraulike,dhe materialeve te ndryshme.Ne proces te realizimit te blerjeve te materialeve{batanije,carcafe,ene kuzhine etj} materialeve te kancelarise. |
| **Sigurimi i ushqimit per nxenesit e konviktit dhe kopeshtin dhe cerdhen me dreke** | Realizimin e sherbimit te menses duke ofruar vaktet e ushqimit per nxenesit qe perfitojne bursa | Sigurimi i vakteve ushqimore per nxenes te konvikteve{perfitues burse} dhe shkolles special. |
| **Krijimi i kushteve optimale per ngrohjen ne shkolla dhe konviktin** | Permiresimi i sherbimit te ngrohjes me qellim funksionimimin sa me normal te procesit mesimor | Realizimi I sherbimit te ngrohjes nepermjet sigurimit te druve te zjarrit,gazit te lengshem dhe nafles ne kaldaja. |
| **Sigurimi i objekteve shkollore per raste te ngjarjeve te jashtzakonshme si zjarr ne konvikte,magazine,kopshte.** | Sigurimin e standarteve per sigurimin ndaj zjarrit. | Ne proces per te realizuar sherbimin e sigurimit ndaj zjarrit. |
| **Permiresimi i kushteve te higjenes ne konvikte,shkolla etj** | Sigurimin e standarteve per sigurimin e higjenes per :konviktet,magazine dhe kopshte etj. | Ne process per te realizuar sherbimin e dezinfektimit ne:konvikte,magazine,kopshte. |
| **Sigurimi i mjeteve didaktike ne kopshte** | Permiresimi i kushteve me ane te sigurimit te materialeve per funksionimin sa me normal te oreve edukative e mesimore | 1. pajisen kopshtet me mjete te nevojshme mesimore ,fatura e palikuiduar detyrim per 2023. |

Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1

| [illegible] | [illegible] | | | | | | Kodi Grupi / Njesia Vendore | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Programi | [illegible] | | | | | | Kodi Programit | [illegible] |
| Art. | Emertimi | 1 Fakt Viti paraardhes Viti 2022 | 2 PBA Plan Viti __2023__ | 3 Buxhet Vjetor Plan Fillestar Viti __2023__ | 4 Buxheti Vjetor Plan i Ndryshuar Viti_2023__ | 5 Buxhet Vjetor Plani Periudhes/progr... | 6 Fakt i periudhes/progr... | (7)=(6)-(5) Diferenca |
| 600 | Paga | [illegible] | | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] |
| 601 | Sigurime Shoqerore | [illegible] | | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] |
| 602 | Mallra dhe Sherbime te Tjera | [illegible] | | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] |
| 603 | Subvencione | | | | 0 | | | 0 |
| 604 | Transferta Korrente te Brendshme | | | | 0 | | | 0 |
| 605 | Transferta Korrente te Huaja | | | | 0 | | | 0 |
| 606 | Transf per Buxh. Fam & Individ | [illegible] | | | 0 | | | 0 |
| Nen Totali | Shpenzimet Korrente | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] |
| 230 | Kapitale te Patrupezuar | | | | 0 | | | 0 |
| 231 | Kapitale te Trupezuar | | | | 0 | | | 0 |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | | 0 |
| Nen Totali | Shpenzime Kapitale me financim te brendshem | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | [illegible] | 0 |
| 230 | Kapitale te Patrupezuar | | | | 0 | | | 0 |
| 231 | Kapitale te Trupezuar | [illegible] | | | 0 | | | 0 |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | | 0 |
| Nen Totali | Shpenzime Kapitale me financim te huaj | | [illegible] | | 0 | | | 0 |
| Totali | Shpenzime Kapitale | [illegible] | [illegible] | [illegible] | 0 | [illegible] | [illegible] | 0 |
| Totali i Programit | | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] |

Realizimi i shpenzimeve te 12-mujorit 2023 per arsimin e mesem,Konviktin e qytetit paraqitet si me poshte .

| Programi P5 | Paga Sigurime | + Shpenzime Operative | Transferime | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| Plani 2023 | 30,748 | 7,710 | 0 | 0 | 38,458 |
| Realizimi 12- | 28,416 | 5,127 | 0 | | 33,543 |

| Bashkia | Fameti | | | | | | Kodi i Grupit / Njësisë Vendore | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Programi | 9230 | | | | | | Kodi i Programit | ... |

| Art. | Emertimi | -1 Fakti i vitit paraardhes Viti 2022 | -2 PBA Plan Viti 2023 | -3 Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023 | -4 Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023 | -5 Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv | -6 Fakti Periudhes/progresiv | (7)=(6)-(5) Diferenca |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 600 | Paga | 6273 | | 7295 | 731 | 8077 | 7439 | 532 |
| 601 | Sigurime Shoqerore | 1042 | | 1161 | 151 | 1212 | 1241 | 71 |
| 602 | Mallra dhe Sherbime te Tjera | 2061 | | 4455 | 30 | 4525 | 1623 | 2802 |
| 603 | Subvencione | | | | 0 | | | 0 |
| 604 | Transferta Korente te Brendshme | 684 | | 1000 | 0 | 1000 | 1000 | 0 |
| 605 | Transferta Korente te Huaja | | | | 0 | | | 0 |
| 606 | Trans per Buxh. Fam & Individ | | | | 0 | | | 0 |
| Nen-Totali | Shpenzime Korente | 10060 | 0 | 13952 | 962 | 14914 | 11103 | 3811 |
| 230 | Kapitale te Patrupezuara | | | | 0 | | | 0 |
| 231 | Kapitale te Trupezuara | 2000 | | 15103 | 0 | 16133 | 14907 | 1226 |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | | 0 |
| Nen-Totali | Shpenzime Kapitale me financim te brendshem | 2000 | 0 | 16133 | 0 | 16133 | 14907 | 1226 |
| 230 | Kapitale te Patrupezuara | | | | 0 | | | 0 |
| 231 | Kapitale te Trupezuara | 0 | | | 0 | | 0 | 0 |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | | 0 |
| Nen-Totali | Shpenzime Kapitale (me financim te huaj) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | Shpenzime Kapitale | [illegible] | [illegible] | [illegible] | 0 | [illegible] | [illegible] | 1226 |
| Totali Korrente + Kapitale | | [illegible] | [illegible] | 30085 | 962 | [illegible] | [illegible] | 4897 |

| Programi P5 | Paga Sigurime | + Shpenzime Operative | Transferime | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| Plani 2023 | 9,389 | 4,525 | 1,000 | 16,133 | 31,047 |
| Realizimi 12- | 8,680 | 1,623 | 1,000 | 14,907 | 26,210 |

F2.

Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O1:

P7. Kultura dhe shërbimet reakreeionale

Hyrje

Permeti, me konfigurimin e ri administrativ, shndërrohet në territorin më të volitshëm për zhvillimin e kulturës. turizmit duke u kthyer në një pikë reference të tërheqjes se vizitorëve vendas dhe të huaj. Pjesë e strategjisë zhvillimore do të bëhen të gjithë ato vlera të trashëgimisë kulturore e natyrore që përbëjnë potencialin kryesor për zhvillimin e turizmit kulturor.

Kjo trashëgimi kulturore e vendosur në një pozitë të favorshme gjeografike, me objekte kulturore që jane kthyer tani ne trashegimi te ketij qyteti, me objekte natyrore te bukura te cilat sot jane kthyer ne faktor kyç për rritjen e turizmit dhe mirëqenies ekonomike të qytetarëve.

9. Politikat e zhvillimit

Pikënisja e programit tonë është mirë menaxhimi dhe administrimi i institucioneve kulturore-artistike, aseteve të trashëgimisë kulturore, duke risjellë në vëmendjen e vizitorëve vlerat dhe pasuritë që disponohen, ndër më të pasurat në vendin tonë si në sektorit , etnografik, historik, te fotografisë. muzikës. etj.

Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të zonave të ndryshme te territorit të Bashkisë Permet.

Muzika folklorike dhe qytetare Permetare, promovimi dhe organizimi i festivaleve të përvitshme dhe aktivitetet kulturore, do të pasurojnë traditën muzikore të qytetit duke gjallëruar jetën artistike në Permet.

Bashkia Permet do të mbështesë dhe kontribuojë në fuqizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve mbështetëse dhe promovuese për librin dhe lexuesit e tij, me synimin e ndërthurjes së politikave vendore .

Funksionet:

F1. Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

**F1.O1: Ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe administrimi e fuqizimi i institucioneve menaxhuese.**

| **Situata e synuar 2023 Objektivat** | **Realizimi i objektivave 12-mujori 2023** | **Realizimi i produkteve 12–mujori 2023** |
|---|---|---|
| Synojme te zhvillojme aktivitete te trashigimise kulturore. | Te zhvillojme aktivite te mbi promovimin e Trashëgimisë kulturore | Janë zhvilluar 3 aktivitete mbi promovimin e Trashegimisë kulturore. |
| Informim dhe promovim i vlerave te trashigimise kulturore ,natyrore Per promovimin e turizmit ne turizmit ne Bashkine Permet. | Mirembajtje e aparateve INFO-POINT per informimi dhe promovimi I vlerave te trashigimise kulturore e natyrore. | Jane vendosur tre qendra informuese. |
| Synojme te zhvillojme aktivite per te perkujtuar datat historike . | Jane realizuar aktivitete per perkujtimin e dative historike sipas kalendarit te festive zyrtare te Bashkise | Eshte bere likuidimi i aktiviteteve te zhvilluara |

Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1

| Bashkia | Fieri | | | | | Kodi i Grupit / Njësisë Vendore | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Programi | 0220 | | | | | Kodi i Programit | |

| Art. | Emertimi | 1<br>Fakti i Vitit paraardhes<br>Viti 2022 | 2<br>PBA<br>Plan<br>Viti ___2020___ | 3<br>Buxheti Vjetor<br>Plan Fillestar Viti ___2023___ | 4<br>Buxheti Vjetor<br>Plan i Rishikuar Viti_2023___ | 5<br>Buxheti Vjetor<br>Plan i Periudhes progresiv | 6<br>Fakti<br>Periudhes progresive | (7)=(6)-(5)<br>Diferenca |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 600 | Paga | 4736 | | 9628 | 683 | 4211 | 3974 | -237 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 702 | | 879 | 120 | 998 | 981 | -18 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 542 | | 901 | 200 | 1131 | 854 | 477 |
| 603 | Subvencione | | | | 0 | | | 0 |
| 604 | Transferta Korente te brendshme | 3428 | | 1000 | 0 | 1000 | 1000 | 0 |
| 605 | Transferta Korente të Huaja | | | | 0 | | | 0 |
| 606 | Transf për Buxh. Fam. [illegible] | | | | 0 | | | 0 |
| Nen-Totali | Shpenzime Korrente | 9508 | 0 | 8378 | 1003 | 9341 | 8809 | 832 |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | | | 4855 | 0 | 4855 | 4274 | 581 |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 0 | | 1360 | 0 | 1360 | 1360 | 0 |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | | 0 |
| Nen-Totali | Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm | 0 | 0 | 6215 | 0 | 6215 | 5634 | 581 |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | 4756 | | | 0 | | | 0 |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 5406 | | | 0 | | | 0 |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | | 0 |
| Nen-Totali | Shpenzime Kapitale me financim të huaj | 10162 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | Shpenzime Kapitale | 10162 | 0 | 6215 | 0 | 6215 | 5634 | 581 |
| Totali Korrente dhe Kapitale | | [illegible] | 0 | 14593 | 1003 | 15556 | 14443 | 1413 |

Realizimi i shpenzimeve 12 M për programin P7. Kultura dhe shërbimet reakreacionale 000/lekë

| Programi P11 | Paga + Sigurime | Shpenzime Operative | Transferta | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| **Plani 2023** | 7,210 | 1,131 | 1,000 | 6,215 | **15,556** |
| **Realizimi 12-mujorit të 2023** | 6,855 | 654 | 1,000 | 5,634 | **14,143** |

**P8. Sportet**

Hyrje
Pjesë e programit për sportet do të jenë organizimi i përvitshëm i aktiviteteve sportive dhe zhvillimi i sportit në komunitet. Këto aktivitete do të zhvillujnë traditën ku të rinjtë dhe të rejat e Permetit, shoqatat e klubet sportive nga vendi ose nga rajoni të garojnë në mes tyre.

Nepermjet programit për sportin do të mbështeten administrimi dhe funksionimi e ekipit te futbollit te Qytetit.Ekipit te basketbollit "The Rosses",Ekipit te pinpongut,Alpinizmit ..

**Politikat e zhvillimit**

Krijimi i infrastrukturës mbështetëse dhe bazës materiale për zhvillimin e proceseve stërvitore për të gjitha ekipet .

Funksionet:

F1.Programet/projektet rinore.

**F1.O1.Te promovojme dhe te nxisim pjesmarrjen aktive te rinjve ne aktivitete sportive dhe sociale, si aktore thelbesore ne zhvillimin e territorit.**

| Situata e synuar 2023 Objektivat | Realizimi i objektivave 12-mujori 2023 | Realizimi i produkteve 12-mujori 2023 |
|---|---|---|
| **Te gjallerojme jeten sociale te te rinjve,nepermjet rritjes se pjesemarrjes se tyre ne aktivitete sportive,promovimit te sportit si veprimtari sociale,integruese dhe burim shendeti,afrimi i te rinjve me sportin por dhe me njeri tjetrin.** | Te promovojme dhe te nxisim pjesemarrjen aktive te rinjve ne aktivitete sportive dhe sociale,si aktore thelbesore ne zhvillimin e territorit. | Jane zhvilluar aktivitete sportive vjetore sipas kalendarit te ndeshjeve per cdo ekip. |
| **Te nxisim dhe te evidentojme talente te reja ne qytetin tone gjate vitit.** | Te evidentojme talentet e reja dhe t i fiojme ne ekipet e qytetit. | |

Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1:

| Bashkia | Pomet |  |  |  |  |  | Kodi i Grupit / Njësisë Vendore |  |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Programi | 01130 Sportet |  |  |  |  |  | Kodi i Programit |  |
| Art. | Emertimi | -1 Fakti i vitit paraardhës Viti 2022 | -2 PBA Plan Viti __2023__ | -3 Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti __2023__ | -4 Buxheti Vjetor Plani i Rishikuar Viti_2023__ | -5 Buxheti Vjetor Plani i Periudhës/progresiv | -6 Fakti i Periudhës/progresiv | (7)=(6)-(4-5) Diferenca |
| 600 | Paga | 1230 |  | 1544 | 55 | 1912 | 1524 | -79 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 201 |  | 245 | [illegible] | 256 | 253 | 0 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 117 |  | 120 | 0 | 120 |  | 120 |
| 603 | Subvencione |  |  |  | 0 |  |  | 0 |
| 604 | Transferta Korrente të Brendshme | [illegible] |  | 4000 | 0 | 4000 | [illegible] | 3796 |
| 605 | Transferta Korrente të Huaja |  |  |  | 0 |  |  | 0 |
| 606 | Trans. për Buxh. Fam. & Individ |  |  |  | 0 |  |  | 0 |
| Nën-Totali | Shpenzime Korrente | [illegible] | 0 | 6909 | 58 | [illegible] | [illegible] | [illegible] |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara |  |  |  | 0 |  |  | 0 |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara |  |  | 65000 | 613 | 65613 |  | 65613 |
| 232 | Transferta Kapitale |  |  |  | 0 |  |  | 0 |
| Nën-Totali | Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm | 0 | 0 | 65000 | 613 | 65613 | 0 | 65613 |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara |  |  |  | 0 |  |  | 0 |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 0 |  |  | 0 |  | 0 | 0 |
| 232 | Transferta Kapitale |  |  |  | 0 |  |  | 0 |
| Nën-Totali | Shpenzime Kapitale me financim të huaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | Shpenzime Kapitale | [illegible] | [illegible] | [illegible] | 613 | [illegible] | [illegible] | 65613 |
| Totali (Korrente + Kapitale) |  | [illegible] | [illegible] | [illegible] | 631 | [illegible] | [illegible] | [illegible] |

**Realizimi I shpenzimeve 12 M për programin P12. Rinia dhe Sportet:**

| Programi P12 | Paga + Sigurime | Shpenzime Operative | Transferta | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| **Plani 12-M 2023** | 1.857 | 120 | 4.000 | 65.613 | 71.590 |
| **Realizimi 12-M 2023** | 1.779 | 0 | 3.905 | 0 | **5.684** |

**P9. Emergjencat Civile**

**Hyrje**

Përballimi i emergjencave civile është detyra të shtetit shqiptar që synon:

- a) parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën, trashegiminë kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile;
- b) sigurimin e kushteve për institucionet shtetërore, publike e private, për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës në një situatë emergjente, me humbje sa më të vogla për ruajtjen e rendit, për jetën e njerëzve, për gjënë e gjallë, për pronën, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin kundër efekteve të një emergjence civile;
- c) garantimin e përdorimit të të gjitha burimeve të mundshme të shtetit, me qëllim sigurimin publik, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë kombëtare, lokalizimin e zonës së emergjencës dhe lehtësimin e pasojave.

Bashkitë kanë përgjegjësi për parapërgatitjen, planifikimin dhe operacionet e përgjigjes ndaj situatave emergjente që ndodhin në territorin e tyre. Menaxhimi i emergjencave civile në bashki bëhet në përputhje me planet e emergjencave ose planet e gatishmërisë që përgatiten periodikisht.

Në nivel vendor krijohet sistem i:

- Njoftimit të hershëm dhe informimit të strukturave kyç.
- Alarmit dhe evakuimit të popullsisë.
- Skuadrave, grupeve dhe strukturave të tjera aktive të përgatitura për të parandaluar, për të lehtësuar dhe për t'u përgjigjur në raste të emergjencave civile.
- Bashkitë Ndërmarrin dhe administrojnë aktivitetet e rehabilitimit për zonën e prekur nga emergjenca

**Politikat e zhvillimit**

Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, prones, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile.

Përafrimi me standartet europiane të organizimit të mbrojtjes civile

Sigurimi i mbrojtjes civile në të gjithë territorin

Parandalimi nga dëmtime ,te emergjencave civile
Informim publik për reziqet dhe aktivitetet e organeve vendore përgjegjëse për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera

Funksionet:

F1.Planifikim, menaxhim, përballim i emergjencave civile.

**F1.O1 Krijimi i strukturave per planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile.**

| Situata e synuar 2023 Objektivat | Realizimi i objektivave 12-mujorit 2023 | Realizimi i produkteve 12-Mujorit 2023 |
|---|---|---|
| Sherbim i qendrueshem per mbrojtjen civile në cdo pjese te territorit.Hedhja e te dhenave ne database te burimeve dhe mjeteve.Vleresim i perditsuar i riskut ne territorin e Bashkise. Trainime te stafit | Perballimi me sukses nga strukturat e Bashkise te situates se krijuar nga permbytjet,zjarret e tj. | Vleresimi i demeve nga specialistet ne banesa,tokave bujqesore dhe blegtorise,zjarret. |
| Realizimi ne kohe sipas ligjshmerise dhenies se ndihmes se menjehershme | Ndihme te menjehershme per 3 familje | |

Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1

| **Aktiviteti** | **Buxheti në mijë Lekë 2023** | **Realizimi 12-mujorit 2023 mijë lekë** |
|---|---|---|
| **P9.F1.O1.A2**, Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie | **2.104** | **359** |

**F2.O1. Shërbim i përmirësuar i MZSH me prioritet parandalimin ngjarjeve**

| Situata e synuar 2023 Objektivat | Realizimi i objektivave 12-mujorit 2023 | Realizimi i produkteve 12-Mujorit 2023 |
|---|---|---|
| Sherbim i mire dhe me efiçent i MZSH,kapaciteteve njerezore te permiresuara | Janë hartuar kalendaret e gadishmerisë dhe kalendaret e kontrolleve per parandalimin e rasteve | Aktivitet i kryer |

Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O1

| Bashkia | [illegible] | | | | | Kodi i Grupit / Njësisë Vendore | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Programi | 3260 | | | | | Kodi i Programit | ... |

| Art. | Emertimi | 1<br>Fakt<br>viti paraardhes<br>Viti 2022 | 2<br>PBA<br>Plan<br>Viti 2023 | 3<br>Buxheti Vjetor<br>Plan Fillestar Viti 2023 | 4<br>Buxheti Vjetor<br>Plan i Rishikuar Viti 2023 | 5<br>Buxheti Vjetor<br>Plan i Periudhes/progresiv | 6<br>Fakt<br>i<br>Periudhes/progresiv | (7)=(6)-(5)<br>Diferenca |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 600 | Paga | 11565 | | 13080 | 1944 | 14944 | 13002 | 5202 |
| 601 | Sigurime Shoqerore | 1931 | | 2067 | 577 | 2644 | 2271 | 373 |
| 602 | Mallra dhe Sherbime te Tjera | 1851 | | 2035 | 850 | 3885 | 2220 | [illegible] |
| 603 | Subvencione | | | | 0 | | | 0 |
| 604 | Transferta Korente te Brendshme | | | | 0 | | | 0 |
| 605 | Transferta Korente | | | 2104 | -359 | 1745 | | 1745 |
| 606 | Transf per Buxh. Fam. & Individ | 230 | | | 365 | 350 | 350 | 0 |
| Nen-Totali | Shpenzime Korente | 16658 | 0 | 20766 | 3171 | 23277 | 18616 | 4660 |
| 230 | Kapitale te Paprekshme | | | | 0 | | | 0 |
| 231 | Kapitale te Prekshme | | | 3338 | -650 | 2688 | | 2688 |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | | 0 |
| Nen-Totali | Shpenzime Kapitale me financim te brendshem | 0 | 0 | 3338 | -650 | 2688 | 0 | 2688 |
| 230 | Kapitale te Paprekshme | | | | 0 | | | 0 |
| 231 | Kapitale te Prekshme | | | | 0 | | | 0 |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | | 0 |
| Nen-Totali | Shpenzime Kapitale me financim te huaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | Shpenzime Kapitale | [illegible] | [illegible] | [illegible] | -650 | [illegible] | [illegible] | 2588 |
| Totali (korente & kapitale) | | [illegible] | [illegible] | [illegible] | 2521 | [illegible] | [illegible] | 7354 |

Realizimi i buxhetit 12-mujori 2023 programi i Emergjencave Civile

| Programi P9 | Paga I Sigurime | Shpenzime Operative | Subvensioni | Transferta | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Plani 2023** | **17,588** | **3,585** | **0** | **2,104** | **2,688** | **25,965** |
| **Realizimi 12-mujorit 2023** | **15,953** | **2,299** | | **359** | **0** | **18,611** |

FUNKSIONI 10: MBROJTJA DHE PERFSHIRJA SOCIALE

Nënprogrami 10 430: Mbrojtja dhe Perfshirja Sociale

**Veshtrim i pergjithshem**

Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, grate e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

**Pershkrim i programit**

- Përfitime monetare ose në natyrë për personat që janë plotësisht ose pjesërisht të paaftë të merren me veprimtari ekonomike ose të bëjnë një jetë normale per shkak të nje gjymtimi fizik ose mendor;
- Përfitime monetare ose në natyrë, si asistencë për detyrat e përditshme për personat përkohësisht të paaftë për punë për shkak sëmundjeje ose dëmtimi (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.);

- Administimi dhe mirembajtja e qendrave rezidenciale për fëmijet me nevoja ndryshe ;
- Administrim dhe organizim ose mbështetje të skemave të tilla të mbrojtjes shoqërore.

Administrimi. dhe rregullimi i sistemit Cerdhe.

**F2.O1.Ofrimi i sherbimeve cilësore për zhvillimin e procesit mesimor edukativ ne kushte të pershtatshme ne gjithe territorin administrativ te Bashkise se Permet.**

| Situata e synuar 2023,Objektivat | Realizimi i objektivave 12-mujori 2023 | Realizimi i produkteve 12 - mujori 2023 |
|---|---|---|
| Kryerje e rregullt e pagesave për paga, sigurime shoqërore dhe shendetsore të punonjesve, në mbeshtetje të permbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizem, korrektesi dhe transperence ne menyre qe cdo punonjes sipas pozicionit te punes te sherbeje, te jape rezultate pozitive duke zbatuar ligjin,vendimet e bashkise dhe urdherat e titullarit te institucionit. | Mbështetje e funksionimit e Cerdhes në Bashkinë Permet për të gjithë personelin, eduator dhe atë mbështetës. | Janë realizuar pagesat për paga dhe sigurime shoqerore për 7 punonjes të personelit edukator dhe të sherbimit mbeshtetes |

Realizimi i buxhetit 12-mujori 2023 programi i Perfshirja Sociale ,Kujdes i femijeve .

| Programi P9 | Paga – Sigurime | Shpenzime Operative | Subvensioni | Transferta | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Plani 2023 | 10,740 | 4,527 | 0 | 3,190 | 12,999 | 31,456 |
| Realizimi 12-mujorit 2023 | 9,334 | 1,968 | | 2,801 | 9,430 | 23,533 |

| Bashkia | [illegible] | | | | | | Kodi i Grupit / Njësisë Vendore | .. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Programi | 10410 | | | | | | Kodi i Programit | ... |
| Art | Emertimi | -1<br>Fakti<br>i vitit paraardhes<br>Viti 2022 | -2<br>PBA<br>Plan<br>Viti ___ 2023 | -3<br>Buxheti Vjetor<br>Plan Fillestar Viti 2023_____ | -4<br>Buxheti Vjetor<br>Plani i Rishikuar Viti_2023_____ | 5<br>Buxheti Vjetor<br>Plani i Periudhes/progresiv | -6<br>Fakti<br>i Periudhes/progresiv | (7)=(5)-(6)<br>Diferenca |
| 600 | Paga | 2452 | | 3856 | 556 | 5207 | 8034 | 2228 |
| 601 | Sigurime Shoqerore | 1241 | | 1505 | 125 | 1506 | 1330 | 176 |
| 602 | Mallra dhe Sherbime te Tjera | 955 | | 4527 | 0 | 4527 | 1963 | 2559 |
| 603 | Subvencione | | | | 0 | | | 0 |
| 604 | Transferta Korente te Brendshme | | | | 0 | | | 0 |
| 605 | Transferta Korente te Huaja | | | | 0 | | | 0 |
| 606 | Trans per Bush. Fam & Individ | | | 3190 | 0 | 3190 | 2801 | 389 |
| Nen-Totali | Shpenzime Korrente | 4655 | 0 | 17798 | 681 | 15457 | 14103 | 4354 |
| 230 | Kapitale te Patrupezueshme | | | 120 | 0 | 120 | 109 | 11 |
| 231 | Kapitale te Trupezueshme | 2185 | 0 | 13402 | 613 | 12179 | 9521 | 3558 |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | | 0 |
| Nen-Totali | Shpenzime Kapitale me financim te brendshem | 2185 | 0 | 13522 | 613 | 12299 | 9630 | 3559 |
| 230 | Kapitale pa trupezuara | | | | 0 | | | 0 |
| 231 | Kapitale te trupezuara | | | | 0 | | | 0 |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | | 0 |
| Nen-Totali | Shpenzime Kapitale me financim te huaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| Totali | Shpenzime Kapitale | [illegible] | [illegible] | 13512 | 613 | 12299 | [illegible] | 3569 |
| Totali Korrente + Kapitale | | [illegible] | [illegible] | [illegible] | 42 | [illegible] | [illegible] | [illegible] |

Funksionet:

F1. Mbledhja,largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane

**F1.O1. Përmiresimi i cilësisë së shërbimit, menaxhimi i mbetjeve të ngurta duke filluar ndarjen në burim të atyre të riciklueshme nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor që bën të mundur përmirësimin e situatës mjedisore dhe reduktimin e sasisë së mbetjeve që depozitohet në landfill.**

| Programi P9 | Paga + Sigurime | Shpenzime Operative | Subvensioni | Transferta | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Plani 2023 | 19,602 | 9,700 | 0 | 251 | 10,747 | 40,300 |
| Realizimi 12- | 18,445 | 4,436 | | 251 | 10,650 | 33,782 |

| Bashkia | Fromat | | | | | | Kodi i Grupit / Njesise Vendore | .. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Programi | 5105 | | | | | | Kodi i Programit | ..... |

| Art. | Shpenzimi | 1<br>Fakti i vitit paraardhes<br>Viti 2022 | 2<br>PBA<br>Plan<br>Viti __2023__ | 3<br>Buxheti Vjetor<br>Plan Fillestar Viti __2023__ | 4<br>Buxheti Vjetor<br>Plan i Rishikuar Viti_2023_ | 5<br>Buxheti Vjetor<br>Plani i Periudhes/progresiv | 6<br>Fakti i Periudhes/progresiv | (7) (6)-(5)<br>Diference |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 600 | Paga | | | 13881 | 1875 | 15766 | 15725 | 1051 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | | | 2367 | 479 | 2840 | 2740 | 106 |
| 602 | Mallra dhe Sherbime te Tjera | | | 9720 | 0 | 9700 | 4436 | 5264 |
| 603 | Subvencione | | | | 0 | | | 0 |
| 604 | Transferta Korrente të Brendshme | | | | 251 | 251 | 251 | 0 |
| 605 | Transferta Korrente të Huaja | | | | 0 | | | 0 |
| 606 | Trans per Buxh. Fam & Individ | | | | 0 | | | 0 |
| Nen-Totali | Shpenzime Korrente | 0 | 0 | 26948 | 2605 | 29653 | 23132 | 6421 |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | | | | 0 | | | 0 |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | | | 10998 | -251 | 10747 | 10650 | 97 |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | | 0 |
| Nen-Totali | Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm | 0 | 0 | 10998 | -251 | 10747 | 10650 | 97 |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | | | | 0 | | | 0 |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | | | | 0 | | | 0 |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | | 0 |
| Nen-Totali | Shpenzime Kapitale me financim të huaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali | Shpenzime Kapitale | [illegible] | [illegible] | [illegible] | -251 | [illegible] | [illegible] | [illegible] |
| Totali Shpenzime | | [illegible] | [illegible] | [illegible] | 2354 | [illegible] | [illegible] | [illegible] |

**TRANSFERTAT E TJERA.**

Realizimi i te ardhurave paraqitet si me poshte :

| Bashkia | Permet | | | | | | Kodi i Njësisë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Programi | 4880 transferta | | | | | | Kodi i P |
| Art. | Emertimi | -1<br>Fakti<br>i vitit paraardhes<br>Viti 2022 | -2<br>PBA<br>Plan<br>Viti<br>___2023 __ | -3<br>Buxheti Vjetor<br>Plan Fillestar<br>Viti<br>___2023_____ | -4<br>Buxheti Vjetor<br>Plan I Rishikuar<br>Viti_2023______ | -5<br>Buxheti Vjetor<br>Plani i<br>Periudhes/progresiv | -<br>Fa<br>Periudhes |
| 600 | Paga | | | | 0 | | |
| 601 | Sigurime Shoqërore | | | | 0 | | |
| 602 | Mallra dhe Sherbime te Tjera | | | | 0 | | |
| 603 | Subvencione | | | | 0 | | |
| 604 | Transferta Korente te Brendshme | 2034 | | 900 | 0 | 900 | 4 |
| 605 | Transferta Korente | | | 3681 | -980 | 2701 | |
| 606 | Trans per Buxh. Fam. & Individ | 899 | | | 980 | 980 | 9 |
| *Nen-Totali* | *Shpenzime Korrente* | 2923 | 0 | 4581 | 0 | 4581 | 13 |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | | | | 0 | | |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | | | | 0 | | |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | |
| *Nen-Totali* | *Shpenzime Kapitale me financim te brendshem* | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | | | | 0 | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 30 | | | 0 | | |
| 232 | Transferta Kapitale | | | | 0 | | |
| Nën - Totali | Shpenzime Kapitale me financim te huaj | 30 | 0 | 0 | 0 | 0 | [illegible] |
| Totali | Shpenzime Kapitale | 30 | [illegible] | 0 | 0 | [illegible] | [illegible] |
| Totali (korrente + kapitale) | | [illegible] | 0 | 4581 | 0 | 4581 | [illegible] |

**PROJEKTET VITI 2023:**

Pervec ketyre aktiviteteve buxheti i bashkise Permet i vitit 2023, perbehej dhe nga pjesa e projekteve te financuara nga BE dhe donator te ndryshem si me poshte :

**Projekti i titulluar "Zhvillimi i turizmit tematik në zonën ndërkufitare duke ruajtur mjeshtërinë e përpunimit të gurit" (Akronimi: STONE.ART- Programi Interreg Greqi-Shqipëri.**

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është ruajtja dhe forcimi i zejtarisë dhe traditës së pëpunimit të gurit të rajoneve të Epirit dhe Shqipërisë së Jugut, si një element integral kulturor i zonës së ndërhyrjes, dhe ta vlerësojë lidhjen me zhvillimin e turizmit tematik.
Partnerët e projektit janë Bashkia e Konicës, Universiteti i Janinës, Universiteti i Gjirokastrës dhe Bashkia Përmet, ku buxheti i Bashkisë Përmet është 121,800 euro (15% cofinancim i Bashkisë)
Arsyeja e mosrealizimit të shpenzimeve ka qënë vonesa në kalimin e fondeve në bankën e nivelit të dytë. Tani që fondi ka kaluar në bankën e nivelit të dytë, do të behen likuidimet përkatëse.

| | Plan | Fakt | % e realizimit |
|---|---|---|---|
| Shpenzime operative (602) | 0 | 0 | 0 |
| Investime (230+231) | 4274 | 297 | 7 % |
| Totali | 4274 | 297 | 7 % |

**Projekti MAPCULT financohet nga Bashkimi Evropian.**
Qëllimi i projektit MAPCULT është të përmirësojë kushtet social-ekonomike dhe promovojë mundësi alternative punësimi për komunitetet e prekura nga kultivimi dhe trafikimi i kanabisit në Bashkinë Përmet, përmes:

(i) Mbështetjes së familjeve fermerë në kultivimin e trëndafilit të egër dhe bimëve të tjera medicinale dhe aromatike, ofrimit të ambienteve për magazinimin dhe tharjen e bimëve si dhe sigurimin e tregut për shitjen e tyre;

(ii) Mbështetjes së të rinjve me arsim fillor dhe/ose të mesëm dhe grave të papuna përmes rritjes së kapaciteteve të tyre dhe ofrimit të ambienteve laboratorike ku mund të prodhojnë produkte kozmetike artizanale duke përdorur si lëndë të parë bimët medicinale dhe aromatike të kultivuara;

(iii) Rritjes së ndërgjegjësimit të publikut kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, me vëmendje të veçantë fshatrat e prekura nga kultivimi i kanabisit, të rinjtë dhe të rejat e familjeve që jetojnë me ndihmë ekonomike dhe të rinjtë dhe gratë e reja të papunë dhe/ose me arsim të ulët.

Grupet e synuara janë:

-Minimumi 20 familje me 2-3 anëtar për familje nga NJA Piskovë dhe Frashër të cilat do të angazhohen në kultivimin e trëndafilit të egër dhe bimëve të tjera medicinale. Prioritet do të kenë

- familjet që jetojnë me ndihmë ekonomike;
- të rinj dhe të reja me arsim fillor dhe/ose të mesëm;
- gra të papunë dhe mbledhës të bimëve mjekësore dhe aromatike në zonë.

-Rreth 30 gra të papuna dhe persona të tjerë nga familjet që jetojnë me ndihmë ekonomike do të trajnohen për prodhimin e produkteve kozmetike nga trëndafili i egër.

Në buxhetin e projektit ishin parashikuar shpenzimet e mëposhtme ( të dhëna në mijë):

| | Plan | Fakt | % e realizimit |
|---|---|---|---|
| Shpenzime operative (602) | 2 904 | 1 317 | 45.4 % |
| Investime (230+231) | 10 723 | 5 924 | 55.2 % |
| Transferta (604) | | | |
| **Totali** | **13 627** | **7241** | **53 %** |

**Projekti INCULTUM** (Duke vizituar kufijtë. Turizmi kulturor inovativ në periferitë Evropiane") financohet nga Bashkimi Evropian. Buxheti total Bashkia Përmet: 26,875 euro

Bashkia Përmet është një nga të paktat bashki në Shqipëri që përfiton nga ky program. Projekti ka në fokus zhvillimin e qëndrueshëm të turizimit kulturor në zonat e pazhvilluara dhe periferike duke u bazuar në identifikimin e potencialeve të reja kulturore dhe rivlerësimin e atyre të njohura më parë, aplikimin e qasjeve inovative shkencore dhe nxitjen e pjesëmarrjes së gjerë të komuniteteve lokale. Projekti do të zbatohet në 10 zona pilote (Portugali, Spanjë, Francë, Irlandë, Suedi, Itali, Sllovaki dhe Greqi), një prej tyre dhe Lugina e Sipërme e Vjosës.

Projekti koordinohet nga Universiteti i Granadës, Spanjë, me pjesëmarrjen e 15 institucioneve kërkimore nga vende të Bashkimit Evropian. Në Luginën e Sipërme të Vjosës, aktivitetet do të kryhen në bashkëpunim me institucionin kërkimor shqiptar - CeRPHAAL.

| | Plan | Fakt | % e realizimit |
|---|---|---|---|

| | | | |
|---|---|---|---|
| Shpenzime operative (602) | 1923 | 924 | 48 % |
| **Totali** | **1923** | **924** | **48 %** |

**Projekti SECO** ( Bashki me energji inteligjente) financohet nga **Swiss State Secretariat for Economic Affairs dhe Minsitria e Infrastrukturës dhe Energjitikës.**
Ky projekt ka si qëllim të përmirësojë menaxhimin bashkiak të energjisë dhe zvogëlojë konsumin e saj, duke promovuar përdorimin e teknologjive energjitike inovatore dhe miqësore me mjedisin. Përfshin ndërhyrjet për ndriçim me eficencë energjia në disa rrugë të përzgjedhura. Arsyeja e mosrealizimit të shpenzimeve ka qënë vonesa në proçedurën e tenderimit.

| | Plan | Fakt | % e realizimit |
|---|---|---|---|
| Investim (231) | 26 018 | 26 018 | 100 % |
| Totali | **26 018** | **26 018** | **100 %** |

**Projekti IN-YEP BP** ( Përmirësimi i aksesit në shërbimet publike për fuqizimin e të rinjëve ) financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të thirrjes BE për Bashkitë.
Qëllimi i projektit është përmirësimin e cilësisë dhe aksesit në shërbimet publike vendore dhe mbështetjen e zhvillimit socio-ekonomik lokal.Buxheti total i mbuluar nga BE: 162,000 euro.
Ndërhyrjet kryesore të parashikuar në projekt janë:Krijimi i një qëndër rinore: godina e ish cerdhes do të rikonstruktohet dhe mobilohet për të shërbyer si qëndër rinore. Në katin e parë të qëndrës do të ketë një sallë për të luajtur vegla muzikore, sallë mbledhjesh, sallë leximi dhe studimi. Në katin e dytë do të ketë një sallë kërcimi dhe salla multifunksionale. Në qëndër do të ofrohen disa shërbime: kurse për vegla muzikore, kërcim, zyrë e këshillimit të karrierës dhe mentorim për të paktën 5 start up rinore.

| | Plan | Fakt | % e realizimit |
|---|---|---|---|
| Shpenzime operative (602) | 0 | 0 | % |
| Investime (230+231) | 11 381 | 10 625 | 93.3% |
| Transferta (604) | 0 | 0 | 0 |
| **Totali** | **11 381** | **10 625** | **93.3 %** |

**Projekti Key People, Key Knowledge** financuar nga Bashkimi Evropian.Buxheti total: 487,449 euro.
Qëllimi i projektit është të krijojë mundësi të reja pune/biznesi për gratë dhe të rinjtë e papunë duke dhënë një alternativë të qëndrueshme ndaj riskut të përfshirjes në kultivimin e kanabisit
Ndërhyrjet kryesore të projektit janë:Rikonstruksioni i ambienteve të Ping Pong në Përmet
Krijimi i një qëndre multifunksionale në Petran.Krijimi dhe funksionimi i një inkubatori biznesi
Rritja e kapaciteteve për start-up dhe mbështetja me grante

| | Plan | Fakt | % e realizimit |
|---|---|---|---|

| | | | |
|---|---|---|---|
| Shpenzime operative (602) | 984 | 628 | 64% |
| Investime (230-231) | 13 080 | 11 848 | 90.6 % |
| Transferta (604) | | | |
| **Totali** | **14 064** | **12 476** | **88.7 %** |

**Ju Faleminderit .**

**Miratoi**

**KRYETAR I BASHKISE**
**Alma HOXHA**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PËRMET**

**P/VENDIM**

**Nr.__datë_____.___.2024**

**PËR**
**MIRATIMIN E LISTËS SË KREDITORËVE PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ___.___.2024, mbështetur në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* nenet 4 dhe 24 , Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, Ligji nr.68 datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"*, Akti normativ nr.6 datë 14.12.2023 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.84/2022 për buxhetin e vitit 2023"*, të ndryshuar, VKB nr.97 datë 18.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024",me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

**V E N D O S I :**

1.Të miratojë listën e kreditorëve për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura si më poshtë:
1.1 Lista emërore për detyrimet e prapambetura për Vendimet Gjyqësore me fonde të parashikuara në strukturën buxhetore:

| Grup | Kod programi | Kapitull | Llogari ekonomike | Kod produkti | Pershkrimi | Vlera totale në lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 00 | AA135 | 01 | 6027 | V11AAG | Shpenzime per detyrime dhe kompesime legale | 3 807 288 |

| Nr | Kreditori | Vlera në lekë |
|---|---|---|
| 1 | ILDI SILA | 117 034 |
| 2 | Anisa Kote | 7 200 |
| 3 | Bebi Ibrahimi | 351 188 |
| 4 | Stefanaq Tovoviti | 149 120 |
| 5 | Spiro Kristollari | 257 680 |
| 6 | Shqiponja Mulla | 246 168 |
| 7 | Orjola Sulejmani | 240 184 |

| | | |
|---|---|---|
| 8 | Odhise Caci | 1 618 184 |
| 9 | Age Gjaci | 390 141 |
| 10 | Sotirаq Ballabani | 328 876 |
| 11 | Vasilika Beo | 101 513 |
| | **TOTALI** | **3 807 288** |

1.2 Lista emërore për detyrimet e prapambetura për Investime me fonde të parashikuara në strukturën buxhetore:

| Grup | Kod programi | Kapitull | Llogari ekonomike | Kod Projekti | Pershkrimi | Vlera totale ( në lekë) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 00 | AB135 | 01 | 231 | P452AAK | Sistemim Asfaltim në rrugë të ndryshme të Bashkisë( detyrim i prapambetur) | 13 196 000 |
| | | | | | **TOTALI** | **13 196 000** |

| Nr | Kreditori | Nr.Kontrate | Vlera në lekë |
|---|---|---|---|
| 1 | HITO 94 | Nr.3270 datë 24.12.2018<br>Fatura nr.7/2021 datë 09.12.2021 | 13 196 000 |

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhet-Financës dhe Tatim-Taksave.Sektori i Buxhet Financës .

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I BASHKISË**

**Alma HOXHA**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PËRMET**

**Përmet, më ____.____.2024**

**RELACION**

**PËR**
**MIRATIMIN E LISTËS SË KREDITORËVE PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA**

**Të nderuar Këshilltarë,**

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, Ligjin Nr 9936 datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republiken e Shqipërisë"*, Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 *"Per menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, Ligjin Nr.68/2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"*,UMF nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit",VKB nr.97 datë 18.12.2023 *"Për miratimin e buxhetit të vitit 2024"* si dhe në zbatim të Aktit Normativ nr.6 datë 14.12.2023 dërguar me shkresën nr.22656/6 datë 20.12.2023 protokolluar me tonën me nr.3387 datë 22.12.2023, Institucionit tonë i është transferuar si transfertë e pakushtëzuar specifike vlera prej 17 003 288 lekë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura .

**Sipas aktit normativ përparësi kanë shlyerja e detyrimeve më të vjetra dhe sipas këtij rregulli ne kemi detajuar listën me emrat (kreditorët) përkatës.**
Nga ana juaj kërkojmë të miratoni listën e kreditorëve për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura sipas tabelës më poshtë:

| Nr | Kreditori | Vlera në lekë |
|---|---|---|
| 1 | ILDI SILA | 117 034 |
| 2 | Anisa Kote | 7 200 |
| 3 | Bebi Ibrahimi | 351 188 |
| 4 | Stefanaq Tovoviti | 149 120 |
| 5 | Spiro Kristollari | 257 680 |
| 6 | Shqiponja Mulla | 246 168 |
| 7 | Orjola Sulejmani | 240 184 |
| 8 | Odhise Caci | 1 618 184 |
| 9 | Age Gjaci | 390 141 |
| 10 | Sotiraq Ballabani | 328 876 |
| 11 | Vasilika Beo | 101 513 |
| | **TOTALI** | 3 807 288 |

Në shumat e lartshënuara për kreditorët të cilët kanë ekzekutuar vendimet e tyre me anë të përmbaruesve janë përfshirë dhe pagesat e tyre.

1. **ILDI SILA** Vendimi Gjyqësor nr.171 datë 25.05.2013 i Gjykatës Së Apelit Tiranë

2. **Anisa Kote** Vendimi Gjyqësor nr.20/2020- 207/77 datë 04.03.2021 i Gjykatës Së Apelit Gjirokastër.

3. **Bebi Ibrahimi** Vendimi Gjyqësor nr. 2021-292/116 datë 01.04.2021 i Gjykatës së Apelit Gjirokastër

4. **Stefanaq Topoviti** Vendimi nr. 20-2021-337/131 datë 08.04.2021 i Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

5. **Spiro Kristollari** Vendimi nr. 20-2021-326/130 datë 08.04.2021 i Gjykatës së Apelit Gjirokastër".

6. **Shqiponja Mulla** Vendimi nr. 20-2021-519/197 datë 10.06.2021 i Gjykatës Së Apelit Gjirokastër.

7. **Oriola Sulejmani** Vendimi nr. 20-2021-531/202 datë 17.06.2021 i Gjykatës Së Apelit Gjirokastër.

8. **Odhise Çaçi Vendimi** nr. 602 datë 01.12.2021 datë i Gjykatës Administrative te Apelit Tiranë

9. **Age Gjaci** Vendimi nr. 20-2022-94/30 datë 23.02.2022i Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

10. **Sotiraq Ballabani** Vendimi nr. 20/2022-251-86 datë 21.04.2022 i Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

11. **Vasilika Beo** Vendimi nr. 20-2022-304/105 datë 11.05.2022 i Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

**Sqarim:**

Në Bashkinë Përmet është depozituar vendimi nr.602 datë 01.12.2021 nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë në datën 17.12.2022 e cila ka vendosur:

**1.** Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Përmet të dëmshpërblej paditësin e mitur Odhise Caci në total në shumën 7.755.850 (shtatë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e pesëmijë e teteqind e pesëdhjetë) lekë

**2.** Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Përmet të dëmshpërblej paditësen Çiljeta Caci në total në shumën 4.443.426 (katërmilion e katërqind e dyzet e tre mijë e katërqind e njëzet e gjashtë)lekë

**3.** Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblej paditësin Josif Caci në total në shumën 4.443.426(katërmilion e katërqind e dyzet e tre mijë e katërqind e njëzet e gjashtë)lekë.

Bashkia Përmet duke u nisur nga fakti që fëmija kishte nevoje për ndërhyrje urgjente ka tejakaluar cdo palë tjetër kreditore që ishte detyrim i lindur me herët dhe ka likujduar një pjesë të konsiderueshme të detyrimit duke ngritur predendime dhe nga zyrat përmbarimore të tjera për kreditoret e me hershëm.Keshtu me Urdhërin shpenzimin nr.298 datë 26.04.2022 pagoi palën kreditore në shumën 2 000 000 (dy milion) lekë. Gjithashtu Bashkia Përmet me urdhër shpenzimin nr.156 date 21.02.2022 ka bërë pagesën në shumën 3 000 000 ( tre milion) lekë. Dhe me urdhërin nr.103 datë 13.03.2023 ka bërë pagesën në shumën 2 755 850 (dy million e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë. Pra shuma e fëmijes sipas vendimit është likujduar totalisht. Nisur nga fakti që është një shumë e konsiderueshme në raport me buxhetin e bashkisë e kemi të pamundur ekzekutimin total të tij, prandaj i jemi drejtuar disa here Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe jemi ne pritje te alokimit te ndonje fondi te vecante per rastin ne fjale.Per kete arsye kerkojme mirkuptimin tuaj te likujdohen totalisht dhe tre kreditoret qe jane pas tij ne radhe (Age Gjaci, Sotiraq Ballabani, Vasilika Beo) duke u nisur nga shuma me e paket qe ata disponojne.

- Bledar Capoku është në proces gjyqësor në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**KRYETAR I BASHKISË**

**Alma HOXHA**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PËRMET**

**P/VENDIM**

Nr.______ datë __/____/2024

**PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË GRANDIT TE MENJËHERSHËM PËR BANESAT ME KOSTO TË ULET**

Këshilli Bashkiak Përmet i mbledhur në datën_____/____/ 2024,Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Bazuar në Ligjin Nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", Vendimin Nr. 555, datë 15.7.2020 "Për procedurat, kriteret dhe përparësitë për akordimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët nga Buxheti i Shtetit", Vendimit Nr. 898, datë 18.11.2020 "Për Rregullat, Kushtet, Kriteret e Procedurat e Privatizimit te Banesave dhe të objekteve të kthyera në fond banese të paprivatizuara", VKB nr 36 datë 30.05.2022 Për miratimin e privatizimit të banesave sociale në Qytetin e Përmetit si dhe vlerën e privatizimit të tyre në favor të përfituesëve , pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Komisioni Konsultativ i Strehimit në Bashki dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

**VENDOSI:**

1- Të miratojë kërkesën e **z.Venetik Hysa** për përfitimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët. Vlera e grantit të menjëhershëm, që përfiton familja do të jetë në masën 10 për qind të çmimit të shitjes së banesës me kosto të ulët në vlerën **163,974** *(njëqind e gjashtedhjete e tre mije e nenteqind e shtatedhjete e kater )* lekë
2- Të miratojë kërkesën e **z.Iliaz Canka** për përfitimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët. Vlera e grantit të menjëhershëm, që përfiton familja do të jetë në masën 10 për qind të çmimit të shitjes së banesës me kosto të ulët në vlerën **153,081** *(njëqind e pesedhjete e tremije e zero tetedhjete e një)* lekë
3- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet, Zyra e financës dhe strehimi në Bashki.
4- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISË**
**ALMA HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA PERMET
ZYRA E STREHIMIT SOCIAL

**RELACION**

**PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TE GRANDIT TE MENJEHERSHEM PER BANESAT ME KOSTO TE ULET NE ZBATIM TE VKM NE 555 DATE 15.07.2020**

***a. Hyrje***

Bashkia Përmet disponon banesa sociale në pronësi të transferuara nga EKB. Bazuar në Ligjin Nr.22/2018 "Për Strehimin Social", Vendimin Nr. 898, datë 18.11.2020 "Për rregullat, kushtet, kriteret e procedurat e privatizimit të banesave dhe të objekteve të kthyera në fond banese të paprivatizuara". Vendim Nr. 89, Datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë,"dokumentacionit tekniko-ligjor për këto banesa, VKB nr. 36 datë 30.05.2022 Për miratimin e privatizimit të banesave sociale në qytetin e Përmetit si dhe vlerën e privatizimit të tyre në favor të përfituesëve," ka filluar proceduren e privatizimit të banesave sociale nr 83/3 (ZBU) dhe 93/3 Lagje e re, pronë e Bashkise Përmet. Kjo procedure referuar Vendimit nr 898 datë 18.11.2020, parashikon kontratë shitjes me reserve të pasurisë ose blerjen e menjëhereshme të këtyre banesave. Nga 22 apartamente, në banesat me nr 83/3 dhe 93/3 janë lidhur 18 kontata nga të cilat 2 banesa janë me blerje të menjëherëshme, të tjerat me këste mujore.

***b. Argumetimi ligjor për përfitimin e grandit të menjëhershëm***

Ne ligjin Nr.22/2018 "Për Strehimin Social" në **Nenin 46** "*Granti i menjëhershëm për banesat me kosto të ulët*" citohet

1. Përfitojnë grant të menjëhershëm familjet të cilat kanë në përbërje:

a) një person me aftësi të kufizuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në nënndarjen "i", të shkronjës "e", të nenit 16, të këtij ligji, për këto kategori;

b) një individ me statusin e jetimit, i cili, në momentin e aplikimit nuk ka mbushur moshën 30 vjeç;

c) kryefamiljarin e vetëm, në rastin kur ka në ngarkim fëmijë nën moshën 18 vjeç;

ç) familjet e komunitetit rom dhe egjiptian.

Shuma e grantit të menjëhershëm, që përfiton individi, është në masën **<u>10 për qind</u>** tëçmimit të shitjes së banesës me kosto të ulët.

**Në pikën 1** te Vendimit nr 555 datë 15.7.2020 citohet: *Njesite e vetëqeverisjes vendore, brenda 30 janarit të çdo viti, paraqesin kërkesat për grante te menjëhershme për banesat me kosto të ulët, prane ministrise pergjegjëse per strehimin për t'u planifikuar në buxhetin e vitit pasardhës.*

**Në pikën** 5 te Vendimit nr 555 datë 15.7.2020 citohet Nga kategorite e parashikuara në nenin 46, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", per përfitimin e grantit të menjëhershëm përfitojnë me përparësi:

***a) kryefamiljarët me aftësi të kufizuara;***

*b) familjet me më shumë se një person me aftësi të kufizuara;*

*c) individët me statusin e jetimit, të cilët jetojnë ne banesa të papërshtatshme ose në konvikte;*

*ç) individët me statusin e jetimit që kanë në ngarkim vëllezër dhe motra, të papunësuar;*

*d) kryefamiljarët e vetëm, viktimë e dhunës në familje;*

*dh) familjet njëprindërore të minoritetit rom dhe egjiptian;*
*e)* ***familjet/individët*** *të parashikuar në pikën 1, të nenit 46, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social",* ***që kanë rënë në vështirësi financiare*** *dhe që rrezikojnë të humbasin banesën me kosto të ulët që kanë blerë me kushte kreditimi.*

***Në pikën 11.*** *Përjashtimisht, kur familja/individi që bën pjesë në kategoritë e përcaktuara në shkronjat "a" e "b", të pikës 1, të nenit 46, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", që ka përfituar banese me kosto të ulët në zbatim të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, "Për programet sociale të strehimit", të ndryshuar, si edhe kur ka përfituar banesë me kosto të ulët me fondet e planifikuara për periudhën 2018 dhe 2019 dhe është në një marrëdhënie kontraktore me një institucion publik ose privat për shlyerjen e kredisë apo të vlerës së banesës, por nuk ka mundur të përfitojë grantin e menjëhershëm apo kur i është krijuar statusi i përcaktuar në shkronjën "a" të pikës 1, të nenit 46, të ligjit nr. 22/2018, pasi ka përfituar banesën me kosto të ulët, mund të paraqesë kërkesë për përfitimin e grantit të menjëhershëm pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore në çdo kohë, së bashku me dokumentacionin përkatës që vërteton statusin. Këto familje/individë e përfitojnë grantin e menjëhershëm, sipas parashikimeve të pikës 10, të nenit 77, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social".*

***c. Të dhëna për familjet aplikuese për përfitimin e grandit të menjëhershëm***

1- **Venetik HYSAJ** me nr ID G11214013B i datlindjes:14.12.1961 eshte përfitues i apapartametit me nr pasurie 28/55+1-15, me strukture 2+1, me sip 84.2 m2 ap.nr-15, shk-,kat V, e ndodhur ne lagjen ZBU sipas dokumentacionit te perfitimit VKB nr 46 date 08.12.2006, formularit nr 1 llogaritja e vleres se apartamentit nga EKB shoqeruar me planimetrine perkatese, Me vertetimin nr 123 date 29.3.2022 te Institutit te Sigurimeve Shoqerore Venetik Hysa përfiton pension invaliditeti të plotë. Plotëson kushtin e pikes 5 germa e të Vendimit nr 555, si dhe pika 1 germa "a" e Nenit 46 e ligjit nr.22/2018

Ventik Hysa ka lidhur me Bashkinë Përmet kontrate shitje me rezerve të pasurise me nr 28/55+1-15 me nr.606 date 19.06.2023 me vlere 1 638 738 lekë. Sipas kontratës bleresi paguan këste mujore, te cilat i ka likujduar deri ne fund të vitit 2023.

2- **Iliaz CANKA** me nr ID G31104102K i datlindjes 04.11.1963 k/familjare i vetem,në veshtiresi ekonomike e familjare, Bashkeshortja e tij Valbona Canka e cila rreth 1 muaj me pare ka nderruar jete, ka qene invalide e plote sipas vertetimit te sigurimeve shoqërore nr 280 date 25.03.2021. Eshte përfitues i apapartametit me nr pasurie nr.1200 date 02.12.2022, me strukture 2+1, me sip 87.1 m2 ap.nr-16, shk-II,kat-IV e ndodhur në lagjen e Re, sipas dokumentacionit të perfitimit VKB nr 84 date 05.12.2017, formularit nr 1 llogaritja e vleres së apartamentit nga EKB shoqeruar me planimetrine përkatëse, Per shkak te problemeve shendetesore familjare të bashkeshortes (të ndjerë) familja e Iliaz Cankës ka ***rënë në vështirësi financiare.*** Plotëson kushtin e pikes 1 të Vendimit nr 555 dhe pikes 1 germa a te nenit 46 të ligjit nr. 22/2018

Iliaz Canka ka lidhur me Bashkinë Përmet kontrate shitje me rezerve te pasurise me nr 25/80+2-8 me nr.1200 date 02.12.2022 me vlere 1 530 808 lekë. Sipas kontratës bleresi paguan këste mujore, te cilat i ka likujduar deri ne fund të vitit 2023.

***d. Të dhëna mbi pasurite për të cilat eshte lidhur kontrate shitje me rezervë***

| Nr | Emeri Mbiemer | Rregj sipas EKB | Nr pasurise sipas hipotekes | Struktura ap. | Sip e ap | Sip e truallit bashkepronesi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Venetik HYSAJ | ap.nr-15, shk- ,kat- | 28/55+1-15 | 2+1 | 84.2 | 22.14 |
| 2. | Iliaz CANKA | ap.nr-16, shk-II,kat-IV | 25/80+2-8 | 2+1 | 87.1 | 22.43 |

**e. Miratimi i vleres së grantit të menjëhershem sipas Shtojces "A" e VKM nr. 555, datë 15.07.2020**

| Nr. | Emër Mbiemër | Kategoria e përfituesit sipas pikës 1, të nenit 46 të ligjit nr. 22/2018 | Kontrata e lidhur me Bashkine Permet | Vlera e shitblerjes sipas kontratës | Shuma e grantit që kërkohet nga buxheti (sipas pikës 2 të nenit 46 të ligjit nr. 22/2018) |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
| 1 | **Venetik HYSAJ** | person me aftësi të kufizuar | Me Bashkine Permet kontrate nr.606 date 19.06.2023 | 1,639,738 | **163,974** |
| 2 | **Iliaz CANKA** | kryefamiljarin e vetëm, në rastin kur ka në ngarkim fëmijë | Me Bashkine Permet kontrate nr.1200 date 02.12.2022 | 1,530,808 | **153,081** |
| | **Totali** | | | | **317,055** |

**f. Sa më lart, i propozojmë Këshillit Bashkiak:**

1- Të miratojë kërkesën e **z.Venetik Hysaj** për përfitimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët në vlerën: 163,974 lekë

2- Të miratojë kerkesen e **z.Iliaz Canka** për pëerfitimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët në vlerën: 153,081 lekë

*Duke shpresuar për miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,*

**KOMISIONI KONSULTATIV I STREHIMT**

Kryetar Aulona Meshini

Anëtar Arian Jaupi

" " Arjana Papapano

" " Entela Bejko

" " Pavlina Hormoviti

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PËRMET**

**Nr._____Prot.**

**Përmet, më __.__.___.2024**

**P/VENDIM**

**Nr. ____ datë .........2024**

**"Për pranim në shtepinë e të moshuarve Gjirokastër"**

Mbeshtetur ne ligjin 139/2015 " Per vetëqeverisjen vendore "; pikës 6 të Nenit Nr.29 te Ligjit Nr.9355, date 10.03.2005"Per Ndihmen dhe Sherbimet Shoqerore" me gjithe ndryshimet V.K.M-se Nr. 209 date 12.04.2006 dhe Udhezimit Nr 2470, date 06.12.2006, V.K.M-se Nr.425 , date 27.06.2012 "Per percaktimin e kritereve dhe dokumentacionit te nevojshem per pranimin e personave ne institucionet rezidenciale " VKM Nr. 839 dt 03.12.2014 Per disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin 425 dt 27.06.2012 "Për kriteret e vendosjes në institucione rezidenciale të përkujdesit shoqëror dhe dokumentacionin e nevojshem për pranim"

**VENDOSI:**

I. Të miratoje kërkesën e paraqitur nga qytetari:

- Gjergji Delilaj vendlindja Përmet/vendbanimi ne Greqi

për t'ju dhenë e drejta e kalimit në Shtëpinë e të moshuarve Gjirokastër për strehim , si banor i Qarkut Gjirokastër nenes te tij Fatbardha Delilaj.

**2.** Kerkohet per znj.Fatbardha Delilaj përkujdesje nga ky institucion per shkak te moshes se saj.

**3.** Dokumentacioni të kaloje ne Shtëpinë e të moshuarve Gjirokaster.

**KRYETAR I BASHKISË**
**Alma HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA PËRMET**

# RELACION
# KESHILLIT BASHKIAK
# PERMET

Te nderuar keshilltare !

Prane Drejtorise se Sherbimeve Sociale ne date 22.08.2024 eshte paraqitur shtetasi Gjergji Delilaj lindur ne fshatin Topojan dhe banues ne Greqi,i cili kerkon te ndimohet nga bashkia per te strehuar nenen e tij Fatbardha Delilaj ne nje shtepi te perkujdesit per te moshuar ne Gjirokaster.

Zonja Fatbardha Delilaj eshte person qe trajtohet me pension dhe kerkon qe te strehoet prane nje institucioni shteteror ,e pikerisht ne shtepine e te moshuarve Gjirokaster ,pasi nuk ka mundesi per tu kjdesur per veten.Eshte ne moshe mbi 70 vjeç ,ka kater femije por qe te gjithe banojne jashte shtetit dhe ajo nuk do te banoje me ta.Femijet i kane vendosur dhe nje grua per tu kujdesur por perseri kerkon nga femijet te interesohen dhe ta vendosin prane shtepise se te moshuarve ne Gjirokaster.Te katert femijet jane dakort qe nena e tyre te strehoet ne shtepine e te moshuarve ne Gjirokaster.

Bashkia ,eshte institucioni perkates qe kujdeset per mireqenien e banuesve ne territorin e saj ,e ne keto kushte duhet te marre masat perkatese per strehimin dhe sistemimin e kerkuesit prane institucioneve shtetrore ne shtepine e te moshuarve ne Gjirokaster.

Dosja gjendet prane Drejtorise se Sherbimit Social.

Mbështetur ne ligjin 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore "; pikës 6 të Nenit nr.29 te Ligjit nr.9355, date 10.03.2005"Per Ndihmen dhe Sherbimet Shoqerore" me gjithe ndryshimet V.K.M-se nr. 209 date 12.04.2006 dhe Udhezimit nr 2470, date 06.12.2006, V.K.M-se nr.425 , date 27.06.2012 "Per percaktimin e kritereve dhe dokumentacionit te nevojshem per pranimin e personave ne institucionet rezidenciale " VKM Nr. 839 dt 03.12.2014 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin 425 dt 27.06.2012 "Për kriteret e vendosjes në institucione rezidenciale të përkujdesit shoqëror dhe dokumentacionin e nevojshëm për pranim" ,kerkojme qe kjo kerkese te merret parasysh dhe shtetesja Fatbardha Delilaj te streohet prane shtepise se te moshuarve Gjirokaster.

Drejtori Sherbimit Social

Arjana PAPAPANO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA PËRMET**

Nr.________prot. Date __.____2024

**P/VENDIM**

**Per miratimin e fondit te kushtezuar per bllok ndihmes ekonomike, deri ne 6% .**

Ne mbeshtetje te ligjit nr.139 date 17.12.2015 "Per vetqeverisjen vendore" ligji nr.9936 date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise, ligji nr.9355, date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore " I ndryshuar me VKM nr.868 dt.29.12.2021 "Per disa ndryshime ne Vendimin 597 dt 04.09.2019 te K.M."Per percaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese,mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike,VKM nr.85 dt 10.02.2021,nr617,date 22.09.2022 i perditesuar: Vendimin e Keshillit Bashkiak Permet me fondet e Buxhetit Vendor.VKB nr.99 date 05.12.2022 "Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2023 dhe percaktimin e numrit te punejseve te bashkise, institucioneve ne varesi te saj" Keshilli Bashkiak,me propozim te Kryetares se Bashkise:

**VENDOSI**

1.Te perfitojne ndihme ekonomike per Muajn Dhjetor 2023, **10** familje me nje fond prej **27.976 leke**

2. Familjet qe perfitojne jane si me poshte:

| Nr | Emri, Atesia, Mbiemri | Bashkeshortja/i | N.ant. | Shuma |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ylli Guçe Pelushaj | Zylkade Qerim Pelushaj | 2 | 3.703 |
| 2 | Roland Petraq Jergji | Divorcuar | 1 | 2.178 |
| 3 | Kadri Petrit Maska | Beqar | 1 | 2.178 |
| 4 | Klodjana Kristofor Peci | Divorcuar | 1 | 2.178 |
| 5 | Lame Enver Ferati | Silvana Kujtim Ferati | 3 | 4.792 |
| 6 | Mimoza Skender Gjoka | Divorcuar | 1 | 2.178 |
| 7 | Lefteri Mihal Tyto | Divorcuar | 1 | 3.146 |
| 8 | Flavia Musa Pelushaj | Beqare | 1 | 2.178 |
| 9 | Lulezim Bajram Beqari | Divorcuar | 2 | 3.267 |
| 10 | Mine Bajram Bejko | Divorcuar | 1 | 2.178 |
| | **SHUMA** | | | 27.976 |

3.Ngarkohen per zbatimin e ketij vendimi sektori buxhet-finance dhe zyra e ndihmes ekonomike.

**KRYETAR I BASHKISE**
**Alma HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA PËRMET

Sheshi "Abdyl Frasheri";tel +35581322254; E-mail: info@bashkiapermet.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA PËRMET**

**Nr.______ _Prot**

**Permet me:___/___2024**

**P/VENDIM**

**PER PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PER FAMILJET NE NEVOJE NGA FONDI 6% DHE FONDI I BASHKISË**

Në 1 Janar 2018 ka hyre ne fuqi sistemi i ri i ndihmes ekonomike, i cili bazohet ne vetedeklarimin që anetaret madhore te familjeve ne nevoje deklarojne prane njesive te tyre vendore. Si rrjedhoje e ketij proçesi jo te gjithe aplikantet dalin fitues nga sistemi i ndihmes ekonomike. Nje pjese e aplikanteve jo-perfitues nga sistemi, kane te drejte te perfitojne nga fondi i kushtezuar 6% mbi bazen e kritereve te propozuar dhe miratuar nga Keshilli Bashkiak, bazuar ne Udhezimin Nr.5 date 17.02.2017 mbi "Perdorimin e fondit te kushtezuar per bllok ndihmen ekonomike ne 6% që MSHMS i akordohet pushtetit vendor.

Familjet do të përzgjidhen në bazë të kritereve të miratuara nga Këshilli Bashkiak dhe masa e pagesës do të llogaritet ne bazë të Udhëzimit Nr. 4 datë 17.02.2017.

Kriteret e përcaktuara për familjet në nevojë dhe që do te trajtohen nga fondi 6% dhe nga fondet e akorduara nga Bashkia.

**VENDOSI**

1. Familje me një prind me të pakten një fëmijë që ndjek arsimin bazë.
2. Persona të vetmuar në moshë para pensionit dhe s'kanë të ardhura të tjera.
3. Familje me më shumë se një fëmijë të lindur njëherësh (binjakë, trinjakë, katërnjakë) dhe pa të ardhura financiare.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BASHKISË**
**Alma HOXHA**

Sheshi "Abdyl Frasheri", tel.: 35581322254; e-mail: info@bashkiapermet.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PËRMET**

# P/VENDIM

**NR._______datë_____.______.2024**

**PËR**

**MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT REZERVË PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore " ,Ligjin Nr. 68 /2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore " i ndryshuar,Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë " i ndryshuar,Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar , Ligji Nr 97/2023 "Për Buxhetin e vitit 2024", Vendimi i KB Nr.97 datë 18.12.2023 "Për Buxhetin e Bashkisë Përmet viti 2024 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj", Këshilli Bashkiak me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

## V E N D O S I

1- Të miratojë përdorimin e fondit rezervë për shpenzime buxhetore të paplanifikuara ( për dhënie ndihmë financiare ) në masën 360.000 ( treqind e gjashtëdhjetë mijë ) lekë, për sa më poshtë vijon:

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1.1 | Nertila | Dervishi | në shumën | 50.000 ( pesëdhjetë mijë ) lekë. |
| 1.2. | Liljana | Gurra | në shumën | 30.000 ( tridhjetë mijë ) lekë. |
| 1.3. | Vera | Mihali | në shumën | 30.000 ( tridhjetë mijë ) lekë. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1.4. Gentian | Çaushi | në shumën | 30.000 ( tridhjetë mijë ) lekë. |
| 1.5. Skënder | Metko | në shumën | 30.000 ( tridhjetë mijë ) lekë. |
| 1.6. Kadri | Zyberi | në shumën | 30.000 ( tridhjetë mijë ) lekë. |
| 1.7. Jusif | Boçi | në shumën | 30.000 ( tridhjetë mijë ) lekë |
| 1.8 Adriana | Lahe | ne shumen | 30.000 ( tridhjete mije ) leke |
| 1.9 Laze | Laraj | ne shumen | 30.000 ( tridhjete mije ) leke |
| 1.10. Dashnor | Pelushaj | në shumën | 20.000 ( njezetë mijë ) lekë. |
| 1.11. Liri | Sotiri | në shumën | 20.000 ( njezetë mijë ) leke |
| 1.12. Spartak | Dalipaj | në shumën | 20.000 ( njezetë mijë ) lekë. |
| 1.13 Zoge | Naqe | ne shumen | 10.000 ( dhjete mije ) leke |

2. Miratimin e transferimit buxhetor si më poshtë .

Pakësimin në strukturën buxhetore :

GR 00,TIT AF135,KAP 01,ART 609,Kod Produkti V494AAA në shumën 360.000 lekë

Shtesa në struktirën buxhetore .

GR 00,TIT AF135,KAP 01,ART 606,Kod Produkti V494AAA në shumën 360.000 lekë

3 Ngarkohet per zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhet-Finances dhe Tatim Taksa/Sektori i Buxhet Financës.

4 Ky vendim dhe hyn në fuqi 10 ( dhjetë ) ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I BASHKISË**

**Alma HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

# RELACION

# DREJTUAR

# KESHILLIT BASHKIAK

Te nderuar keshilltare!

Prane Drejtorise se Sherbimeve Sociale,ka paraqitur kerkesen e saj shtetesja Nertila Dervishi banuese ne Permet e cila kerkon te ndimohet financiarisht nga ana e bashkise,pasi eshte ne gjendje te veshtire ekonomike, bashkeshortin e ka te semure me tumor dhe nuk i perballon dot shpenzimet e kurimit te tij.

Bashkeshorti i saj vuan nga semundje te ndryshme dhe shpesh here shtrohet ne spitale.

Kjo familje ka dhe probleme shendetesore per femijet dhe kane shpenzime te medha per blerjen e ilaçeve te tyre.

Njekohesisht prane Drejtorise se Sherbimeve Sociale,ka paraqitur kerkesen e tij shtetesi Josif Boçi, banuese ne Njesine Administrative Çarçove i cili kerkon te ndimohet financiarisht nga ana e bashkise,pasi eshte ne gjendje te veshtire ekonomike, bashkeshortja i ka nderruar jete , vete eshte i semure me prostat eshte operuar dhe nuk i perballon dot shpenzimet e kurimit te tij.

Edhe shtetesja Liljana Gurra ka paraqitur kerkese per tu ndimuar financiarisht nga ana e bashkise pasi ndodhet ne veshtiresi te medha financiare pasi eshte operuar dhe kurat per te jane shume te shtrenjta dhe nuk i perballon dot.

Gentian Çaushi ka kerkuar te ndimohet financiarisht nga bashkia ,eshte i semure se do operohet nga shtylla kurizore ,trajtohet me ndihme ekonomike, ilacet per trajtimin dhe kurimin e tij jane shume te shtrenjta dhe nuk i perballon dot.

Shtetesi Kadri Zyberi, kerkon te ndimohet financiarisht nga bashkia pasi do operohet se eshte i semure ,eshte ne gjendje shume te veshtire ekonomike

dhe shpenzimet per operacionin dhe kurimin e tij jane te medha.

Shtetesja Liri Sotiri banuese ne fshatin Kaludh,kerkon te ndimohet financiarisht pasi eshte ne gjendje te veshtire ekonomike pasi familja e vajzes se saj ka pesuar fatkeqesi.

Shtetasi Dashnor Pelushaj kerkon te ndimohet nga ana e bashkise pasi eshte ne gjendje te veshtire ekonomike,eshte i semure me prostat dhe kurimet per semundjen e tij jane te shtrenjta.

Shtetasi Skender Metko banues ne fshatin Bodar,ka paraqitur kerkese prane bashkise dhe kerkon te ndimohet financiarisht pasi eshte i semure me trompoze ne te dy kembet,eshte operuar nga gjendrat tiroide dhe kurimi per semundjen e tij eshte shume i kushtueshem dhe nuk i perballon dot shpenzimet.

Prane bashkise ka paraqitur kerkese edhe shtetasi Spartak Dalipaj banues ne Permet i cili kerkon te ndimohet financiarisht nga ana e bashkise pasi eshte ne gjendje te veshtire ekonomike,si vete dhe djali trajtohen me kemp,me femije minorene dhe bashkeshorten e ka pa pune.Shpenzimet per te jane te paperballueshme.

Edhe shtetesja Vera Mihali banuese ne Permet,e pa pune ka paraqitur kerkese per tu ndimuar financiarisht nga ana e bashkise pasi ka operuar bashkeshorin e saj dhe shpenzimet per kimjo jane shume te larta dhe nuk ka mundesi financiare per ti perballuar ato.

Shtetesja Adriana Lahe,banuse ne Njesine Administrative Piskove ka paraqitur kerkese prane bashkise ku kerkon te mbuloje shpenzimet e transportit per dy femijet e saj te semure te cilet marrin trajtim prane qendres me aftesi ndryshe e cila ndodhet ne qytetin e Permetit.

Edhe shtetasi Laze Laraj,banues ne Permet,ka paraqitur kerkese prane bashkise dhe kerkon te ndimohet financiarisht pasi eshte i semure me tumor,ka kryer nje operacion ne stomak ,trajtohet me kimio dhe kurimi per trajtimin e kesaj semundje kushton shtrenjte dhe ai nuk eshte ne gjendje ti perballoje shpenzimet.

Shtetesja Zoge Naqe ka paraqitur kerkese prane bashkise per tu ndimuar financiarisht pasi eshte e vetmuar,te tre femijet i kane vdekur dhe eshte ne gjendje te veshtire ekonomike per te perballuar shpenzimet ditore.

Bazuar ne Ligjin 139/2015 date 17.12.2015 " Per Veteqeverisjen Vendore " ,Ligjin Nr. 68 /2017 " Per financat e veteqeverisjes vendore ",Ligjin 9936 date 26.06.2008 " Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise "i ndryshuar,Ligjin Nr.10296 date 08.07.2010 " Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar ,VKB Nr.97 date 18.12.2023 " Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2024 dhe percaktimin e numrit te punonjesve te bashkise dhe institucioneve ne varesi te saj,kerkojme nga ana juaj te merren ne konsiderate kerkesat e shtetesve :

Nertila Dervishi te ndimohet perkatesisht ne shumen 50.000 ( pesedhjete mije ) leke.

Josif Boçi te ndimohet perkatesisht ne shumen 30.000 ( tridhjete mije ) leke.

Skender Metko te ndimohet perkatesisht ne shumen 30.000 ( tridhjete mije ) leke.

Liljana Gurra te ndimohet perkatesisht ne shumen 30.000 ( tridhjete mije ) leke.

Gentian Çaushi te ndimohet perkatesisht ne shumen 30.000 ( tridhjete mije ) leke.

Kadri Zyberi te ndimohet perkatesisht ne shumen 30.000 ( tridhjete mije ) leke.

Liri Sotiri te ndimohet perkatesisht ne shumen 20.000 ( njezete mije ) leke.

Dashnor Petushaj te ndimohet perkatesisht ne shumen 20.000 ( njezete mije )leke.

Spartak Dalipaj te ndimohet perkatesisht ne shumen 20.000 ( njezete mije ) leke.

Vera Mihali te ndimohet perkatesisht ne shumen 30.000 ( tridhjete mije )leke

Adriana Lahe te ndimohet perkatesisht ne shumen 30 .000 ( tridhjete mije ) leke.

Laze Laraj te ndimohet perkatesisht ne shumen 30.000 ( tridhjete mije ) leke.

Zoge Naqe te ndimohet perkatesisht ne shumen 10.000 ( dhjete mije ) leke.

Bashkengjitur i gjithe dokumentacioni perkates.

Drejtori Sherbimit Social

Arjana PAPAPANO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA PËRMET**

**Nr.________Prot.** **Date___.___ .2024**

**P/VENDIM**

Per dhenie titulli " Qytetar Nderi i Qytetit" Znj.Ollga Popli ( pas vdekjes )

Ne mbeshtetje te ligjit nr.139 date 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore" neni 54 pika m.neni 55 e ne vijim, Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".Ligji Nr.94/2022 " Per titujt e nderit dhe titujt vendore te nderit ne Republiken e Shqiperise,nenet 8 e ne vijim, si dhe të VKM- së Nr.861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërise

**VENDOSI**

1 – T'i jape Znj.Ollga Popli ( pas vdekjes ) titullin "Qytetar Nderi i Permetit" me motivacionin :

***"Personalitet me vlera intelektuale me një kontribut të çmuar në fushën e arsimit,per pasionin, vlerat dhe arritjet profesionale, në përmbushjen e misionit të edukimit të nxënësve."***

2- Ky vendim shpallet Brenda 10 diteve nga data e miratimit.

KRYETARI
Alma HOXHA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

# RELACION

## DREJTUAR : Keshillit Bashkiak

## PERMET

Te nderuar keshilltare !

Ne mbeshtetje te ligjit nr.139 date 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore" neni 54 pika m,neni 55 e ne vijim, Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", "Ligji Nr.94/2022 " Per titujt e nderit dhe titujt vendore te nderit ne Republiken e Shqiperise,nenet 8 e ne vijim, si dhe të VKM- së Nr.861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë" ,prane bashkise eshte paraqitur kerkesa e shtetases Zhuljeta Popli ( Lole ) per dhenien e titullit "Qytetar Nderi i Permetit "per Znj.Ollga Popli ( pas vdekjes ).
Kerkojme nga ana juaj miratimin e ketij titulli te nderit.
Materialet jane bashkengjitur ne dosje.

DREJTORI SHERBIMIT SOCIAL
Arjana PAPAPANO

Pilivinë Mërlimi Për ndjekje

Përmet më. 23.08.2022

**LËNDA** : Kërkesë për shpallje "Nder i Qytetit " për Zj.Ollga Popli( pas vdekjes)

**DREJTUAR** : Këshillit Bashkiak Përmet

## INFORMACION

Ollga Popli( Zallari ) ose Zonja,siç e thërriste jo vetëm masa e nxënësve por edhe qyteti ynë ,u lind në 15 maj 1914 në një familje të varfër përmetare në Përmet.

Dhe pse e mbetur jetime që në moshë të vogël nga nëna( Athina Avrami)për rritjen,edukimin dhe arsimimin e saj u kujdesën babai i saj Qako Zallari dhe njerka e saj.Katër klasët e para të shkollës fillore i kreu në Përmet.Në klasë të pestë i del bursa dhe shkon në Korçë ku krahas fillores këtu mbaron dhe shkollën Normale (Pedagogjike), në vitin shkollor 1930-1931 .Diploma e saj nr 57 dhe ndanze 151 ,lëshuar nga shkolla Normale Femërore Korçë, më 30 korrik 1931, flet për një nxënëse shumë serioze në punë ku në të lexojmë: " Sjellja e saj ka qënë e shëmbëlltyrshme" dhe nga 15 lëndë të zhvilluara 11 kanë qënë me rezultatin "Shkëlqyeshëm " ,4 lëndë "Shumë mire",duke fituar të drejtën e emërimit si mësuese në shkollat fillore të shtetit.

Emërimi i parë është më 1 tetor 1931 në Shkollën Femërore Përmet.Pas dy vitesh për punë të mirë emërohet Zv/drejtoreshë e kësaj shkolle,që e përforcon detyrën e saj drejtuese edhe me mbarimin e stazhit më 20 prill 1935 pranë Institutit Femëror "Nëna Mbretëreshë" në Tiranë.

Më 9 shtator 1938 martohet me bashkëqytetarin Petraq Vangjel Janpopli,me profesion dentist.Mbas një martese të lumtur dhe me lindjen e tre fëmijëve ,Vangjushi në 1938,Harallambi në 1941 dhe Natalinë 1944 ,për Zonjën pas vitit 1945 fillon një kalvar i vërtete,sepse në 15 shkurt 1946 bashkëshortin e saj e dënojnë me 30 vjet burg ,i etiketuar si "Armik e tradhëtar i popullit".

Megjithëse karakteristikat për Zonjën janë shumë kontradiktore ,ajo del e padëshirueshme për fëmijët nxënës të Përmetit dhe pse me tre njomëzak e transferojnë në fshatin Mashkullorë në vitin shkollor 1947-1948 dhe vitin tjetër

shkollor në Libohovë.Por edhe në këto dy shkolla mbetet po ajo mësuese dhe edukatore e respektuar.Këtë natyrë ajo e kishte treguar gjatë LANÇ-it, simpatizante dhe ndihmëse e saj për pritjen dhe përcjelljen e luftëtarëve për liri,Alqi Kristo,Mustafa Matohiti( Hero i Popullit) me shokë ,duke vënë në dispozicion të tyre edhe shtëpinë e saj apo ngjallte në shpirtin e njomë të të vegjëlve urretjen kundër fashizmit.Madje ishte edhe drejtuese e gruas për qytetin e Përmetit në vitin e parë të çlirimit.

Por pavarësisht se çfarë ndodhi për shumë ish nxënës të saj e masën e përmetarëve , mësuesja e shumë brezave përmetarë,Zonja ,vazhdonte të ishte vërtet Zonjë shumë e respektuar.Me daljen para kohe të bashkëshortit të saj Petraqit nga burgu,ata do të jenë prindër edhe të fëmijës së katërt Zhulietës, më 1958.

Petraqi do të punësohet pa humbur kohë dentist në Ambulancën e qytetit të Përmetit deri sa doli në pension i nderuar dhe respektuar nga qytetarët.

Ti deshën vitet e demokracisë që Zonja e nderuar të vlerësohej me titullin "Mësuese e Merituar" dhe këtë titull e meritonte me të vërtetë.

Ata e mbyllën jetën e tyre pranë vajzës së tyre të vogël Zhuljetës në qytetin e Beratit.

Kohë pse mësuese e zonja Ollga ( nuk jeton më) për ne ish nxënësit e saj do të mbetet për seriozitetin në punë,për fjalën e ngrohtë jo vetëm mësuese por edhe nënë.

Gazeta Përmeti ,mars 2007

**Dhimitraq Lole**

**Me respekt e bija ,Zhuljeta Popli( Lole)**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA PËRMET**

**Nr.________prot.** **Përmet më___.____.2024**

**P/VENDIM**

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJI JANAR 2024**

Në mbështetje te ligjit nr 139 date 17.12.2015 "Per vetqeverisjen vendore" ligji nr.9936 date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise, ligji nr.9355, date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore "I ndryshuar me VKM nr 869 date 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe mases mujore të përfitimit te ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtese, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike. VKM-në nr.85 datë 10.02.2021;868,29.12.2021;NR.617,date22.09.2022 I perditesuar Vendimin e Këshillit Bashkiak Përmet me fonde të Buxhetit Vendor, VKB nr.97 date 18.12.2023 "Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2024 dhe percaktimin e numrit te punojseve te bashkise, institucioneve ne varesi te saj "Keshilli Bashkiak me propozim te Kryetarit te Bashkise:

**VENDOSI**

1.Te perfitojne ndihme ekonomike per Muajn **JANAR** 2023, **29** familje me nje fond **71.178 leke**

2.Fondet te perballohen nga struktura :

**1.Gr.00.Tit.AC135.Kap.01.Art.606.Kod projekti V043AAD per shumen 71.178 leke**

3. Familjet qe perfitojne jane si me poshte:

| Nr | Emri, Atesia, Mbiemri | Bashkeshortja/i | N.ant. | Shuma/leke |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Zise Apostol Kristo | Valentina Polikron Kristo | 3 | 2400 |
| 2 | Xhilda Xhemal Selimllari | Xhilda Xhemal Selimllari | 2 | 2700 |
| 3 | Mitro Gani Zeqiri | Lefteri Rrapi Zeqiri | 4 | 3000 |
| 4 | Syrja Mehmet Hoxha | Beqar | 1 | 2600 |
| 5 | Drita Irakli Kosta | Divorcuar | 2 | 2100 |
| 6 | Lefteri Polikron Proko | E ve | 1 | 3000 |
| 7 | Andon Dhimitraq Kukureci | I ve | 2 | 3000 |
| 8 | Aferdita Nuredin Lahe | Beqare | 1 | 1800 |
| 9 | Arben Thoma Teka | Mirela Xheli Teka | 6 | 3000 |
| 10 | Viktor Josif Proko | Divorcuar | 1 | 1800 |
| 11 | Dhimo Naun Dimçi | Landita Hysen Dimçi | 3 | 2400 |
| 12 | Vera Thanas Naqe | E ve | 2 | 2100 |
| 13 | Leonard Petro Markaj | Kristina Petraq Markaj | 3 | 2100 |

Sheshi "Abdyl Frasheri";tel. 035581322254; e-mail: info@bashkiapermet.gov.al

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 14 | Thoma Aristidh Ilia | Maria Nuredin Ilia | 4 | 3000 |
| 15 | Xhensila Maksim Jaujaj | Beqare me Femijë | 2 | 2600 |
| 16 | Violeta Guce Pelushi | Beqare | 1 | 1800 |
| 17 | Engjellushe Manxho Canollari | E ve | 1 | 3000 |
| 18 | Rivelino Fatmir Doko | Burma Leonidha Doko | 4 | 3000 |
| 19 | Bajame Fari Hysenshahaj | E ve | 1 | 1800 |
| 20 | Areti Çume Koshe | E ve | 2 | 2100 |
| 21 | Lida Koco Thomollari | Divorcuar | 1 | 2600 |
| 22 | Vasilika Bedri Malka | E ve | 2 | 2400 |
| 23 | Ilir Sali Jashari | Beqar | 1 | 1800 |
| 24 | Vitori Llazo Caci | Beqare | 2 | 2100 |
| 25 | Luan Ferit Zeneli | Gezime Tafil Zeneli | 4 | 3000 |
| 26 | Ilber Kudret Dalipaj | Divorcuar | 1 | 1800 |
| 27 | Kastriot Kristo Koto | Kastriot Kristo Koto | 3 | 3000 |
| 28 | Kastriot Asrit Male | Divorcuar | 1 | 2178 |
| 29 | Vangjush Thanas Mamillo | Gentiana Seit Mamillo | 3 | 3000 |
| | **SHUMA** | | | **71.178** |

1. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhet-Financës dhe Tatim –Taksa/Sektori i Buxhet Financës.

5. Ky vendim dhe hyn në fuqi 10 ( dhjetë ) ditë nas shpalljes.

**KRYETAR I BASHKISE**
**Alma HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIP
BASHKIA

**RELACION**

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR MUAJIN DHJETOR 2023**

Mbështetur në Ligjin Nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"Ligji Nr.9936 date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise "Ligji 9355 date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore"I ndryshuar me VKM Nr. 955 date 07.12.2016 (kreu II pika 13)dhe udhezimi nr.5 date 17.02.2017 pika 2 i Ministrise se Mireqenies Sociale dhe Rinise.Per percaktimin e kritereve,dokumentacionit dhe mases se perfitimit te ndihmes ekonomike si dhe VKM nr.85 dt.10.02.2021,nr.868,date 29.12.2021;nr.617,date 22.09.2022 I perditesuar Vendimi i.Keshillit bashkiak Permet me fonde te Buxhetit Vendor Nr.99 date 05.12.2022"Per miratimin e Buxhetit te Bashkise per vitin 2023 dhe percaktimin e numurit te punonjesve te Bashkise ,insitucioneve ne varesi te saj"Keshilli Bashkiak ka te drejte te trajtoje me ndihme ekonomike familjet aplikuse qe nuk jane shpallur perfituse nga sistemi i pikezimit,deri 6% te bllok ndihmes ekonomike te muajit.Dhjetor 2023 me Vendim te Drejtorise Rajonale te Sherbimit Social Gjirokaster.Nr.10/2022 date 27/10/2022 per dhenien e NE per periudhen 01-31-12-.2023,per Bashkine Permet.(sipas vndimit te Muajit Dhjetor 2023)

Per sa me siper vlera e fondit te kushtezuar (bllok ndihma ekonomike) per Muajin Dhjetor

2023 eshte 65 familje me .Shumen prej **440.195** leke dhe per tu trajtuar familje me ndihme ekonomike **jane ne dispozicion 6% e ketij fondi ose 26.411 leke,per Muajin Dhjetor 2023.**

Mbeshtetur ne te dhenat per dhenien e Ndihmes Ekonomike per periudhen 1-31 Dhjetor 2023 kane aplikuar 10 familje 2 kanë dalë fituese 65 jane perfituese ne skemen e Ndihmes Ekonomike.

Nga shqyrtimi dhe vleresimi i aplikuseve qe nuk kane mare piket e mjaftueshme per periudhen 01 Dhjetor deri me daten. 31 nga vleresimi i SH.S.SH.rekumandojme :

**Të perfitojne ndihme ekonomike nga fondi kushtezuar prej 6%. 10 familje me vlere 27.976 leke**,nga ku fondi 6% ne toal sipas vendimit eshte ne Shumen **26.411** leke diferenca prej 1565 leke do te perballohet nga fondi i lekeve te papërdorura i cili eshte ne Shumen 15.455 leke.. Trajtohen dy individe me statusin jetime.me 19.800 lek.,nga 9.900 leke secili,sipas VKM Nr.868date 29/12/2021.

Mbeshtetur ne kete VKM , Keshilli Bashkiak ka te drejte te trajtoje me ndihme ekonomike familjet aplikuese qe nuk jane shpallur perfitues nga fondet NE, i Bashkise Persa me siper **rekomandojme te ndihmohen per muajin Janar 2024, 29 familje me nje vlere prej 71.178 leke.**

**Specialisti i NE**

**Jurigen SIMONI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA PËRMET**

# P/VENDIM

**Nr. datë ____.____.2024**

**PËR**
**PËRDORIMIN E FONDIT PËR EMERGJENCAT CIVILE**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës __.__.__.2024, mbështetur në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore ", Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë " nenet 4 dhe 24 ,Ligjit nr.68 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore "Ligjit nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", VKB nr.97 datë 18.12.2023 "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Përmet viti 2024", Ligji nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile ", Shkresës nr.155/2 datë 23.01.2024 të Repartit Ushtarak Nr 4040 (Xhenijo) "Për vlerësimin e situatës për kryerjen e operacionit special xhenier në masivin shkëmbor në fshatin Çarçovë, bashkia Përmet" :

**VENDOSI:**

1.Të miratojë përdorimin e fondit për shpenzime udhëtime dhe dieta të forcave xheniere për kryerjen e ndërhyrjes special për prishjen e masiveve shkëmbore në fshatin Çarçovë në vlerën 462 000 lekë.

2.Fondet per mbulimin e këtyre shpenzimeve do të përballohen nga struktura buxhetore:
Të pakësohen shpenzimet në strukturën buxhetore:
00.AF135, KAP 1, 609, Kod Produkti V494AAA në vlerën 462 000 lekë.

Të shtohet shpenzimet në strukturën buxhetore:
00.AF135, KAP 1, 602, Kod Produkti V494AAA në vlerën 462 000 lekë.

3.Sasia prej 980 litra do të mbulohet nga struktura buxhetore 00.AF135, KAP 1, 602, Kod Produkti V528AAC e parashikuar në Buxhetin e Bashkisë Përmet.

4.Baza materiale për zërat e mëposhtëm do të mbulohen nga gjendja aktuale e magazinës.

| Nr. | Emërtimiizërittëpunës | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| 1 | Lubrifikant | litra | 18 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Tel Xingato | kg | | 10 | |
| 3 | Doreza | palë | | 12 | |

5.Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhet-Finances dhe Tatim-Taksave, Sektori i Buxhet Finances dhe Sektori i Mbrojtjes Civile.

6.Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

**KRYETAR I BASHKISË**

**Alma HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA PERMET

**RELACION**

Në zbatim të 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile", shkresës së Kryetarit të bashkisë drejtuar Ministrit të Mbrojtjes me nr 2985, datë 07.11.2023 "Kërkesë me specialist xhenier dhe mjete për neutralizimin e masiveve shkëmbore" si dhe urdhrit të Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA nr.397, datë 07.11.2023 "Për dërgim ekspertësh xhenier në mbështetje të EC, ju informojmë se:

Në datën 22 Janar 2024 në fshatin Carcove ka ndodhur një rast i fatkeqësisë natyrore ku një masiv shkëmbor është shkëputur duke rënë mbi një banesë. Duke parë situatën nga ana e Bashkisë është kërkuar vlerësim i specializuar nga ana e forcave të xhenjos. Një ekip xhenier prej 4 (katër) forcash, zhvilluan përnjohjen për vlerësimin e situatës në masivin shkëmbor për mundësitë së shpërthimit të komanduar shkëmbinjve në fshatin Carcove. Njësia Administrative Carcove, bashkia Përmet.

Nga kontrolli, verifikimi, kqyrja e masivit shkëmbor rezulton se shkëmb i cili është spostuar nga rrëshqitja e parë shfaq problematikë, volume i tij është rreth 23 m3. Gjithashtu është konstatuar dhe një shkëmb tjetër me volum 8 m3 i cili rezikon stalla të bagëtive.

Situata është emergjente duhet ndërhyhet sa më shpejt pasi shirat e stinës se dimrit, mund të sjellin rrëshqitje të tjera guresh dhe mund te kete premisa për ngjarje te jashtëzakonshme.

Batalioni i xhenios ka kapacitete në personel, teknike dhe baze materiale për eliminimin e situatës së shkaktuar. Operacioni special xhenier do te kryhet sipas një plani operacional dhe një plani bashkëpunimi me bashkinë Përmet. Eliminimi i problematikës, prishja e kontrolluar e shkëmbinjve do të kryhet e kombinuar me prishje mekanike me matrapik dhe goditje me eksplozive të shkëmbinjve duke marrë masa paraprake të forta sigurie ndërtimi i pengesave të perforcuar me rrjet teli, profile metalike të përforcuara me saldim.

Afati i kryerjes së operacionit të jetë 7 ditë.

Volumet e punës të përafërta që do të kryhen janë si më poshtë:

| | |
|---|---|
| Transport bazë material distanca (rrjeta, shtylla) | 200 ml |
| Hapje gropash me krahë dhe matrapik | 10 cope |
| Ndërtim pengese rrjet teli mbi shkëmbinj | 30 m |
| Ndërtim pengesash me rrjet teli | 80 m |
| Hapje furnelash me pistolet shpimi nga 08-1.2 ml | 170 cope |
| Armatosje fugasesh (vendosje LP, FD, taposje) | 170 cope |
| Përgatitje lëndë plasëse plastike | sipas llogarive dhe testeve në objekt |
| Përgatitje argjile për taposje | 500 kg |
| Ndërtim rrjeti fitil detonant | 300 ml |
| | |
| Përgatitje gypash ndezës për realizimin e plasjeve. | sipas llogarive dhe testeve në objekt |
| Shkatërrim shkëmbi me mina | 27 m3 |
| Shkatërrim shkëmbi me matrapik | 9 m3 |
| Skarifikim shkëmbi me krahë | 5 m3 |
| Rehabilitimi i sipërfaqes nën masiv shkëmbor | 1500 m2 |
| Çmontimi i pengesës dhe ngarkimi në mjet | 80 m2 |

Kostoja përafërt e operacionit është:

karburant lubrifikant 980 * 180   176400
lubrifakt   18 * 400 = 7200
trajtim personeli   12 * 7 * 5500 = 462000
nastro (izolant)   6 * 100 = 600
shirit adeziv   2*100 = 200.
sprile   1*400 = 400
tel xingato   10*140 = 1400
tel bari   4 x 140   560
doreza pune   12*100 = 1200

Kostoja e përafërt operative totale e operacionit është: 645,600 lekë (bashkia 643,840 dhe BaXh 1,760).

Bashkia Përmet merë përsipër:

Personel sigurie (polic) për sigurimin e personelit dhe teknikës gjatë zhvillimit të operacionit, si dhe shoqërimit të municionit xhenier.
Kqyrjen e operacionit me 1 person.
Mbështetja me mjek/ndihmës mjek dhe mjet ambulancë gjate zhvillimit të operacionit.
Ruajtja e municionit xhenier në një vend të sigurt.
Sigurimi i bazës materiale pas zhvillimit të operacionit.
Largimin e banorëve në momentin e kryerjes së shpërthimit
Ndërprerjen e energjisë elektrike në momentin e shperthimit.
Njoftimin e istuticioneve Pushtetit Vendor.
Mbyllja e anës dokumentare.
Bashkia merr përsipër shpenzimet e operacionit në vlerën 643,840 lekë.
Persa i perket zerave
- karburant do te mbulohet nga sasia qe bashkia ka aktualisht ne strukturen e MNZSH-se. Sasia e karburantit do te kompesohet per MNZSH ne momentin qe do te kryhen veprimet dhe per dy raste te tjera te evidentuara deri me tani, ne fshatin Zhepe dhe Petran i Vjeter.
- tel xingato, doreza pune dhe lubrifikant do te mbulohet nga gjendja aktuale ne magazine.

Ju faleminderit!

**KRYETARI I BASHKISE**
**Alma HOXHA**